



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 11 DHE 18 PRILL 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. I 18. APRILA 2017. GODINE**

**PRILL - APRIL
2017**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet,
5. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.
7. Shqyrtimi i Propozim - Programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-132 për automjete,
11. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021,
12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me Propozim-vendimin nr. 20/2017, datë 10 mars 2017, të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit,
13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë,
14. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë,
15. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Glasanje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o rudnicima i mineralima,
5. Glasanje predloga Rezolucije u vezi hapšenja aktivista Pokreta "Vetëvendosje",
6. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
7. Razmatranje predloga Programa rada Skupštine Republike Kosova za 2017 godinu,
8. Prvo razmatranje N/zakona o osposobljavanju, profesionalnom ponovnom osposobljavanju lica sa severnog dela Mitrovice,
9. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-118 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-139 o izvršnom postupku,
10. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-132 o vozilima,
11. Razmatranje Nacionalnog programa za sprovođenje Sporazuma o stabilizaciji- pridruživanju za period 2017-2021,
12. Razmatranje preporuke Komisije za ljudska prava, ravnopravnost polova, nestala lica i peticije u vezi predloga-odluke br. 20/2017, od 10 marta 2017, Narodnog advokata za izbor pet (5) zamenika Narodnog advokata,
13. Razmatranje izveštaja Komisije za nadgledanje Kosovske agencije za inteligenciju u vezi sprovođenja Zakona br. 03/L-178 o klasifikaciji informacija i proveru sigurnosti.
14. Razmatranje Izveštaja Komisije za obrazovanje, nauku, tehnologiju, kulturu, omladinu i sport, u vezi nadzora sprovođenja Zakona br. 03/L-145 o osnaživanju i učešću omladine,
15. Izbor jednog (1) člana Nezavisne Komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Diskutimet janë të kufizuara deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Atëherë, unë që tash po ju them është mirë që, meqë janë 30 minuta, së pari të paraqiten ata që flasin në emër të grupeve, në mënyrë që të mos ndodhë të mbetet dikush në emër të grupeve dhe të harxhohet koha për deputetë. Nëse ka kohë, do të flasin edhe të tjerët.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, a flet dikush? Nuk flet. Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”? Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, zoti Haradinaj. Unë thashë në emër të grupeve, sepse pastaj deputetët e veçantë nuk ju lënë kohë.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

E kam vërejtur se pas një deklarate që e kam lëshuar ka pasur reagime të shumta, qoftë brenda Kosovës, edhe jashtë. E përsëris edhe një herë, e kam thënë me plot vetëdije atë deklaratë. Është shumë e vërtetë që ajo deklaratë është kapur për bishti dhe kujt i ka konvencuar ajo, le ta mbajë përgjegjësinë vetë.

Kushdo që ka dilema se çka është duke ndodhur në Kosovë dhe rreth Kosovës, duhet ta kuptojë se ka tendenca për ta destabilizuar këtë vend. Ata të cilët sot po krekosen për serbët e Kosovës, është mirë të na tregojnë neve haptazi se si ndodhi vrasja e “pandave” në Pejë, e fëmijëve të Pejës, për t’i fajësuar shqiptarët e Kosovës?

Unë kam folur, e përsëris edhe një herë, të kihet kujdes se nuk luhet më me kombin tonë. Nuk ka provokim më të madh se nëpërmes një njeriu të tentohet ta destabilizojnë vendin. Nëse e kanë atë qëllim, le t’i implementojnë ato agjenda diku tjetër. Këtë duhet ta dinë edhe përfaqësuesit diplomatikë, se po e marrin një njeri peng për qëllime të caktuara, e që e kanë shumë gabim. Kurrkush më shumë se sa unë vetë nuk e do paqen dhe stabilitetin e Kosovës. Asnjë prej qeveritarëve serbë nuk i kanë ruajtur as serbët e Kosovës, as monumentet historike, as kulturore, i kemi ruajtur vetë, se e kemi kulturë si shqiptarë.

Ata, të cilët po tentojnë, e që janë sot janë udhëheqës në Beograd, duhet ta dinë mirë se nuk lëshojmë pe më. Përgjigjen e njëjtë sa herë të duan do ta marrin, qysh e kanë marrë më '98-'99. Kurrkush nuk na e ka falur lirinë, e kemi fituar vetë, bashkë me përkrahjen e miqve tanë. U bëj thirrje të gjithë atyre që e kanë interpretuar, e kanë kapur për bishti një deklaratë timen, asnjëherë nuk kam thënë që do të ketë spastrim etnik. Por, në rast se mendojnë se nëpërmjet një njeriu, ose transferimin e tij në Beograd, duhet t'ia vënë gishtin kokës, të kenë kujdes! Ata janë duke tentuar ta spastrojnë Kosovën, Beogradi zyrtar tenton ta spastrojë Kosovën etnikisht, jo Daut Haradinaj, jo shqiptarët. Por, në rast se duan të luajnë me zjarr, puna e mbarë u qoftë! Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Zonja dhe zotërinj deputetë!

Në seancën e sotme kemi mundur që në rendin e ditës ta kishim Shqyrtimin e Projektligjit për FSK-në. Edhe më herët, edhe sot kemi mundur ta bëjmë një gjë të tillë. Kosova ka mundur ta kishte ushtrinë e saj, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kurse sot, përveçse një FSK me mandat të kufizuar në fushën e sigurisë, Kosova ende nuk e ka një ndër elementet më esenciale të shtetësisë, siç është ushtria e saj.

Por, përse ne ende nuk kemi ushtri?! Ne nuk kemi ushtri, sepse qeverive të Kosovës u ka munguar vizioni dhe vullneti politik për një gjë të tillë. Ne nuk kemi ushtri, sepse qeveritë e Kosovës nuk e kanë bërë punën e domosdoshme që Kosova ta kishte tashmë forcën e saj të armatosur, kurse sot ne nuk e kemi në rend të ditës as Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për FSK-në, sepse në zyrën presidenciale e kemi një njeri manipulues. Në zyrën presidenciale e kemi një njeri, i cili asnjëherë nuk e pa të nevojshme ta garantojë atë që vraponte ta shpallte me egoizëm pavarësinë e Kosovës. Një njeri, i cili po vazhdon edhe sot e tutje të luajë me diçka që nuk luhet, me sigurinë e vendit, rrjedhimisht, me sovranitetin e Republikës së Kosovës. Kështu njëjtë bëri edhe në fund të mandatit të tij qeverisës si kryeministër në vitin 2014. Solli në seancën e fundit në Kuvend amendamentet kushtetuese për shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcë të Armatosur dhe i tërhoqi ato pa u dhënë fare rast deputetëve që t'i votojnë.

I solli me qëllim për t'i dështuar ato, sepse qëllimi i krejt asaj ndërmarrjeje nuk ishte bërja e Forcave të Armatosura të Kosovës, por vazhdimi i vendeve të rezervuara për partnerin, të cilin e kishte krijuar si vepër në bashkëkryerje, siç është Lista serbe. Tash, ai pas procedimit që ne e mirëpritëm, tërhoqi Projektligjin për FSK-në për t'i hapur rrugë kësaj teme në Bruksel.

Edhe atëherë Lëvizja “Vetëvendosje” e kishte të njëjtin qëndrim siç ka edhe sot për plotësim-ndryshimin e këtij ligji. Ne ofruam votën tonë edhe për ndryshime kushtetuese për FSK-në, siç

ofruam edhe votën tonë për ndryshimet ligjore për Projektligjin për FSK-në. Por edhe atëherë, edhe tash një njeri dhe pushteti i tij, bashkë me koalicionin PDK- LDK-Lista Serbe, e rrezikuan sigurinë e vendit duke manipuluar me këtë temë. Ai njeri me aventurat e tij egoiste sot ka vënë në rrezik edhe të tashmen, edhe të ardhmen e ushtrisë së Kosovës, ka vënë në rrezik partneritetin me aleatët strategjikë, siç është NATO-ja, SHBA-ja dhe Bashkimi Evropian, si pasojë asnjëri nga këta aleatë nuk i patëm në anën tonë sa i përket FSK-së, jo pse ata nuk e duan që Kosova të ketë ushtri, por se ata nuk mund të bëhen pjesë e asnjë skenari elektoral.

Deklarimet e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-së dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian veç e veç, për ne janë shqetësuese. Prandaj, sot Kosova është në një pozicion shumë të pafavorshëm sa i përket raporteve tona me aleatët perëndimorë në bërjen e ushtrisë. E ushtria i duhet edhe Kosovës, por edhe vetë NATO-s, edhe partnerëve tanë strategjikë. Sikur Kosova të kishte ushtrinë e saj, sot kjo do të ishte përveç një garanci për sovranitetin e vendit, do të ishte e mirë edhe për vetë NATO-n, sepse Kosova do të merrte barrë të rëndësishme nga barra që ka KFOR-i në Kosovë.

Për krejt këtë ne e bëjmë përgjegjës një njeri, i cili rri në zyrën presidenciale, e që quhet Hashim Haxhi Thaçi. E veç sa për t'ia kujtuar edhe atij, edhe juve këtu, ai pati dhënë një premtim, dorëheqjen. Ne veç po ia kujtojmë, duke ditur se ai asnjëherë nuk e mban fjalën. Po ia rikujtojmë dorëheqjen, sepse ai e premtoi si kusht të moskalimit, prandaj sot dorëheqja e këtij njeriu do të duhej të vinte si pasojë e kësaj rrjedhoje. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të “Nismës”, kush flet? Zonja Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

U bënë dy muaj që nga adresimi jonë i fundit në këtë foltore të Kuvendit, kjo për faktin që kjo Qeveri, por edhe Kuvendi tashmë e sa kohë nuk janë duke funksionuar dhe kjo po shihet tashmë edhe me pasqyrën e mospranisë të asnjë ministri në këtë kryesi, edhe pse koalicioni më i madh që nga paslufta, po del të jetë koalicioni më i dëmshëm për vendin, koalicion që shkatërroi çdo institucion të varur dhe të pavarur prej saj.

Shtrohet pyetja: Kujt po i konvenon kjo situatë kështu? Sepse, kur kishit për të miratuar marrëveshje dhe ligje të dëmshme, ju shkonit edhe nëpër tavane duke improvizuar salla, ndërsa kur ju është kërkuar të punoni për mirëqenien e qytetarëve, për ndërtimin e shtetit, për arsim, për shëndetësi, për zhvillim ekonomik, për bujqësi, për drejtësi, për ta luftuar krimin e korrupsionin, ju jeni sjellë si të shurdhër ndaj vërejtjeve tona, e tash ju ka rënë ndërmend të dilni dhe t'i dëgjoni qytetarët për hallet e tyre të rënduara nga politikat e këtij koalicioni, e arsyeja tashmë është e ditur: jemi pra në një prag zgjedhor.

Thujse qytetarët kanë obligim t'i kryejnë dhe t'i përmbushin premtimet tuaja, e ju jo. Nuk mund t'i ikni përgjegjësisë me turne të ndryshme që po i mbani, nuk mund t'i ikni përgjegjësisë për mashtrimet, për gënjeshtat, për dëmet që i keni bërë tre vjet nga kjo qeverisje. Të jesh në qeveri gati 10 vjet e të mos fillosh me turne, sikur të ishit nga dje, kjo definitivisht është një absurditet i llojit të vet. Ashtu siç janë përgjegjës Thaçi, Mustafa, ashtu edhe zoti Veseli është përgjegjës, sepse po ashtu këto zgjedhje zoti Veseli i ka fituar me sloganin e "misionit të ri". Mision, i cili ishte mision i mashtrimit, i keqpërdorimit, mision i cili e krijoi dëbimin e mbi 100 mijë qytetarëve nga vendi, mision i cili e solli PISA-n, e solli varfërinë, shkatërrimin ekonomik, forcimin e ndikimit të Serbisë brenda Kosovës, shkatërroi komplet shëndetësinë, shkatërroi institucionet e pavarura, mision i cili e shkatërroi sistemin e drejtësisë, mision i cili i la të izoluar qytetarët e vendit, mision i cili prioritet e kishte dialogun me Serbinë, e qytetarin e vet e kishte të fundit.

Ky ishte pra misioni, e tash po përsëritet e njëjta storie, i njëjti film, por me një "lider" të ri. Prandaj, ky fillimi i ri nuk është tjetër pos përsëritje e mashtrimeve nën sloganin e misionit të ri, ose thënë ndryshe, është fillim dhe vazhdim i mashtrimeve të radhës, por jo vetëm nga PDK-ja, ashtu edhe nga LDK-ja, me të njëjtën strategji, pra prapë për t'i mashtruar qytetarët. Pse nuk po bëni turne nëpër institucione, nëpër spitalet tona, ku po rrezikohen edhe foshnjat nga moskujdesi, e lëre më të rriturit që askush nuk kujdeset për ta, edhe pse e kanë obligim, por ja që kanë marrë shembull nga ju, duke shkelur edhe mbi betimin e tyre. Është koha të jepni llogari për secilin premtim që e keni bërë, e që asnjë nuk e mbajtët. Ja pra për çka është dhe si funksionon ky koalicion, secili në keqpërdorim të parasë së qytetarëve, sepse po shfrytëzohet edhe paraja e Kuvendit për kampanja të liderëve të partive në pushtet. Dhe, jo vetëm Peja, zoti Veseli, por edhe Gjilani, Prizreni, Mitrovica, Prishtina, Gjakova, Ferizaj, Suhareka, Fushë-Kosova, Vushtria, sepse thujse të gjitha komunat e tjera e kanë të njëjtin problem, sepse ju e keni rritur numrin e të papunëve në vendin tonë.

Nëse e konsideroni punësim largimin e kuadrove tona jashtë vendit, kjo nuk duhet kurrë të lejohet, sepse largimi i kuadrove do të thotë dobësim i shtyllave të shtetit. Pasqyrë më konkrete e kishim situatën ditë më parë, ku mbi 5 mijë qytetarë konkurronin për 70 vende pune. Prandaj është për të mirën e qytetarëve dhe të vendit që sa më parë të dorëzoheni dhe sinqerisht çdo ditë e juaja në qeverisje, do të thotë çdo ditë mbytje e shpresës së qytetarëve për një të ardhme më të mirë.

KRYESUESI: Atëherë, fjalën e ka deputetja Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike,

Dua të shpreh shqetësimin tim lidhur me kërcënimin që ka marrë kryeredaktorja e gazetës “Zëri”, zonja Arbana Xharra. Ky akt si i tillë është përpjekje për ta ndalur fjalën e lirë në Republikën e Kosovës.

Kosova si shtet, i cili synon vlerat evropiane e perëndimore, duhet të promovojë dhe të sigurojë fjalën e lirë, veçanërisht nëse bëhet fjalë për një femër. Personat që kanë vizatuar një simbol në formë kryqi me ngjyrë të kuqe, dje në hyrje të banesës së zonjës Xharra, ende nuk janë gjendur, prandaj unë si deputete u bëj thirrje organeve të drejtësisë që ky rast të hetohet dhe të zbardhet sa më shpejt. Viteve të fundit në Kosovë ka shumë raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, veprimet e tilla kërcënuese janë të papranueshme dhe të patolerueshme për secilin gazetar në Kosovë, e posaçërisht në rastin e fundit ndaj zonjës Arbana Xharra, e cila është vlerësuar si njëra ndër gazetaret më të guximshme edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Ekzistojnë raste të shumta vendore, raporte vendore dhe ndërkombëtare të gazetarëve në Kosovë që janë të frikësuar, të kërcënuar, e në disa raste edhe janë sulmuar fizikisht, andaj edhe një herë u bëj thirrje organeve të drejtësisë që t’i hetojnë këto raste sa më shpejt.

Si duket, sfida kryesore për lirinë e medias që u përsëritën gjatë viteve të fundit në Kosovë kanë të bëjnë kryesisht me sundimin e ligjit. Edhe pse legjislacioni kyç është miratuar apo është ndryshuar vitet e fundit, prapë problem mbetet zbatimin i tij. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Sipas një studimi, janë miliona euro shpenzime shtesë që i kanë bërë bizneset kosovare si pasojë e çmimit të lartë të energjisë dhe shpeshherë mungesës së saj. Meqenëse bizneset konsiderohen si bartës të zhvillimit ekonomik të vendit, institucionet relevante që merren me sektorin e zhvillimit duhet t’i marrin në konsideratë dhe t’i adresojnë këto shqetësime, vështirësitë dhe pengesat me të cilën po përballen bizneset vendore, në mënyrë që t’i eliminojnë këto barrierë dhe t’u ndihmohet atyre që të mos rëndohet më shumë gjendja e tyre.

Në këtë drejtim, do të dëshiroja që përgjegjësit apo dikasteret që merren me zhvillimin ekonomik të trajtojnë shumë seriozisht vështirësitë që u shkakton KEDS-i bizneseve prodhuese vendore. Së pari, kjo kompani nga ajo që po shohim për çdo ditë largon punëtorë nga puna dhe si rezultat i kësaj kemi protesta të shumta të këtyre punëtorëve. Nuk dihet se sa ka investuar në rrjetin shpërndarës në bazë të kontratës që ka pasur dhe nuk ka arritur të ketë furnizim të rregullt me energji elektrike dhe për këtë ende kemi reduktime nëpër fshatra dhe qytete të Kosovës.

Mungesa e energjisë elektrike pa dyshim që u shkakton telashe të shumta prodhuesve vendorë. Për këtë shtroj pyetjen: Pse kjo kompani nuk investon në riparimin e tërësishëm të rrjetit ekzistues? Pse nuk siguron tension stabil aty ku ka biznese private dhe qytetarë? Pse i kushtëzon bizneset që të investojnë në largpërçuesit e tensionit të ulët? Pse nuk vendos njehsorë dykohorë aty ku ka energji solare të ripërtëritshme, pra nuk e paguan tepricën e kësaj energjie, e cila shkarkohet me rrjetin elektroenergjetik.

Në një kronikë televizive më ka rënë t'i shoh vështirësitë si përballat një prodhues vendor si rezultat i ndërprerjes së energjisë elektrike, i cili për 21 ditë nuk ka pasur energji elektrike në fabrikën e tij. Kjo i ndodhi fabrikës së ujit "Kika" në Kamenicë dhe, siç deklaroi pronari i saj në televizion, askush nuk i jep përgjigje, sepse përgjegjësi jo se jo! Edhe sa raste të tilla mund të ketë, të cilët nuk shfaqen në media, prandaj përgjegjësit apo kompetentët e kësaj fushe duhet t'i shikojnë dhe t'i eliminojnë këto barriera që u bënë KEDS-i prodhuesve vendorë.

Konsideroj se institucionet tona duhet të kenë objektiv kryesor dhe të punojnë në drejtim të krijimit, ngritjes, rritjes, mbështetjes dhe fuqizimit të sektorit privat, në mënyrë që të jetë sa më atraktive për sipërmarrësit e rinj që t'i zhvillojnë bizneset e tyre, të cilët rrisin mundësitë e punësimit të të rinjve, e në nivel të vendit do të kemi rritje të punësuarve e në të njëjtën kohë zvogëlimin e varfërisë. Në të kundërtën, ata që kanë shpirt ndërmarrës do të gjejnë mundësi dhe vende të tjera që janë më atraktive për t'i zhvilluar bizneset e tyre. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Fjalën e ka Jasmina Zhivković. Regjia, ju lutem, fjalën e ka Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIČ: Zahvaljujem predsedavajuća!

Poštovani kolege, danas mi nije bila namera da se javljam za reči, i nemam unapred pripremljen pisani tekst u vezi ovoga što ću reći.

Povod je izjava naše kolege od prošle nedelje i današnja potvrda da je ta izjava izrečena svesno i da je i iskorišćena javnost da bi se tako nešto izjavilo i da bi se ceo narod izložio strahu i pretnji od pravnog procesa.

Ja ovu instituciju želim da iskoristim da sve pozove na mir i toleranciju. Ne želim da moje reči izazovu neki dublji jaz i veći razdor, jer je krajnje vreme da ovakve izjave i ovakvi postupci ne budu prihvaćeni u ovom društvu, i da krajnje vreme da se takve izjave osuđuju i ne samo osuđuju, nego da se i na neki način kažnjavaju, jer se društvo ne gradi na takvim izjavama.

Želim u svoje ime, u ime Srpske Listi i u ime srpskog naroda da naglasim da nakon čuvanja preostalih srpskih narod na Kosovu nije kriv i odgovoran za vođenje bilo kakvog pravnog

procesa, i da ne moze da tako bestidan nacin pretiti i izjavljivati da se srpski narod stavlja u bojazan oko ishoda pravnog procesa.

Da li to znači da srpski narod, srpski narod na Kosovu, treba bojati bilo kog drugog pravnog procesa ili ćemo ipak graditi pravno društvo i verovati u pravni sistem. Još jednim želim da pozovem i sve iskoristim ovu govornicu da je vreme mir i toleranciji i da ne dođe do nikakvih neželjenih sukoba i ne željenih situacija. Hvala na razumevanju i hvala predsedavajući na datoj reč.

KRYESUESJA: Fjalën e ka Bislim Zogaj.

BISLIM ZOGAJ: E nderuar kryesuese,

Të nderuar deputetë,

Dua të shpreh një shqetësim për padrejtësinë që po u bëhet kategorive të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Komisioni qeveritar për verifikimin dhe njohjen e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit dhe veteranit të UÇK-së kishte ndërprerë punën në korrik të vitit të kaluar për shkak të mosfinancimit të këtij komisioni nga qeveria.

Megjithatë, komisioni deri në atë kohë kishte bërë verifikimin dhe njohjen e statusit të dëshmorëve të kombit, invalidëve dhe veteranëve, i kishte bërë edhe listat, në ndërkohë u ishin shpërndarë edhe certifikatat të familjeve të dëshmorëve të kombit, por kishte mbetur puna pa u kryer për dhënien e vërtetimeve që të kenë mundësi të hyjnë në procesin e pagesave. Në pyetjen parlamentare që i kisha bërë kryeministrit në seancën plenare më 30.11.2016 ishte përgjigjur ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, zoti Abrashi, i cili pati deklaruar, citoj: “Jemi duke punuar në disa procese. Te procesi i verifikimit të dëshmorëve të UÇK-së është hapur procesi në Qeveri dhe mendoj se deri në fund të dhjetorit mbyllet, pasi komisioni do të punojnë në verifikimin e atyre dhe deri në fund të dhjetorit do t’i kemi edhe listat e dëshmorëve dhe pastaj ata futen në procesin e pagesës. Kurse tek invalidët e UÇK-së është proces ndaras, por jemi duke punuar në pako të përgjithshme edhe me veteranët, dhe shumë shpejt edhe ky proces do të kryhet”.

Edhe përkundër këtij deklarami procesi ende nuk vazhdoi, prandaj unë përsëri në seancën e 2. 3. 2017 ia përsërita pyetjen ministrit, por në vend të tij u përgjigj kryeministri dhe përsëri asgjë konkrete. Para dy javësh ka filluar punën Komisioni për dhënien e vërtetimeve të veteranëve të luftës, fillimin e punës së këtij komisioni e përshëndesim, po për mua është e pakuptimshme dhe e papranueshme përse nuk ka filluar dhënia e vërtetimeve edhe për familjet e dëshmorëve të kombit, të luftës së UÇK-së, si dhe dëshmorëve të kombit të periudhave të mëhershme, kur tani më dihet se statusi u është pranuar dhe listat janë të gatshme, e kur numri i tyre është shumëfish më i vogël se sa numri i veteranëve.

Vetëm 5-6 ditë pune nevojiten për t'u dhënë vërtetimet këtyre familjeve dhe këto pastaj mund të futen në procesin e pagesave. Pastaj, pse nuk po formohet komisioni për vlerësimin e shkallës së invaliditetit të atyre veteranëve, të cilëve u është pranuar statusi i invalidit. Gjithnjë deklarohemi se kategoritë e dala nga lufta meritojnë respekt dhe trajtim të veçantë, por kur vjen puna te kompensimi, nuk e kryejmë obligimin ndaj tyre. Të gjithë ata që kontribuuan për lirinë dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës meritojnë respekt, por familjet e dëshmorëve janë të shenjta dhe e gjithë shoqëria jonë duhet t'i ketë prioritet mbi prioritetet këto familje.

Prandaj, kërkoj nga Qeveria, gjegjësisht nga ministritë gjegjëse që t'i zbatojnë ligjet që i kemi miratuar në Kuvend, vendimet që i ka miratuar Qeveria dhe sa më parë t'i fusë në lista të pagave familjet e dëshmorëve, të cilëve u është pranuar statusi si dhe të fillojë punën komisioni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më 21 mars, nëpërmjet një konference për media, sekretari organizativ i Lëvizjes “Vetëvendosje”, Dardan Molliqaj, bëri publike rezultatet e një sondazhi të realizuar nga kompania “UBO Consulting”, në projektin “OMNI BUS”.

Prej asaj kohe segmente kriminale të pushtetit në Kosovë u vunë në veprim për të kompensuar përjetimin e rëndë që patën shefat e tyre, për shkak të rritjes së përkrahjes për “Vetëvendosjen”. Kjo u vu re edhe nga deklaratimet dhe reagimet e zhurmshme pas këtij publikimi, kjo po vërehet edhe këtu. Më datë 22 mars, në orën 23 e 37 mesnatë, eksponentë nga pushteti i krimit në tentativë për të sulmuar sekretarin organizativ, Dardan Molliqaj, sulmuan me shufra hekuri aktivistin tonë, Agron Kabashi, në kokë, fytyrë dhe trup. Sot janë bërë 20 ditë prej kur ka ndodhur sulmi ndaj tyre dhe, ndonëse policia ka qenë bashkëpunuese në këtë rast, ende nuk janë identifikuar kryerësit e këtij sulmi kriminal.

Me motiv të ulët politik u thyen para ca ditëve edhe zyrat tona në qendrën e Vushtrrisë, ku u vodhën kompjuterë dhe dokumente, por me motiv të njëjtë ishte edhe dënimi prej gjashtë muaj burgim që iu dha aktivistit tonë nga Peja, Besnik Zeqiraj, nga Gjykata Themelore e Pejës pa asnjë provë të vetme. Sigurisht që këto metoda janë të njohura nga të gjithë ne, edhe arsyen pse bëhen, por këta ende më duket nuk e kanë të qartë që ne aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” as s'ju kemi frikën, e as nuk tërhiqemi. Sa më shumë ju shtoni dhunën, aq më shumë na shtohen radhët. Ata që sulmojnë prapa krahëve dhe në errësirë, janë as më shumë e as më pak kriminelë, por mbi të gjitha frikacakë. Në këtë vend janë parë shumë agresorë, me pushtet, të huaj, shqiptarë, po ashtu janë parë edhe shumë forma të viktimizimit hipokrit.

Ne si dhe mijëra qytetarë të tjerë nuk jemi as si të parët dhe as si të dytët, por dua t'ia kujtoj nga këtu sot secilit që i ka shkuar në mendje apo edhe e ka zgjedhur si formë presioni sulmin ndaj nesh: nuk keni për ta ndalur dot rritjen tonë! Do të humbni përballë nesh në çdo drejtim. Sot edhe në bazë të sondazheve të fundit, por edhe në bazë të vizitave në terren, po dëshmohet se ne jemi e ardhmja. Nuk ka asnjë mundësi që të na ndalni. Koha juaj politike tashmë ka mbaruar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shpejtim Bulliqi.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, nënkryetare!

Të respektuar qytetarë të Kosovës,

Të respektuar kolegë deputetë,

Arsyeja pse desha ta marr fjalën sot është çështja e ujit të pijshëm për banorët e fshatrave të Orllanit me rrethinë.

Siç jeni edhe ju të informuar, por edhe opinionimi publik, qytetarët e fshatrave të Orllanit me rrethinë, dikur më se 400 banorë të këtyre lokaliteteve, edhe sot e kësaj dite, përkundër faktit se nga akumulacioni i Batllavës furnizohet pothuajse pjesa dërmuese e qyteteve të Kosovës me ujë të pijes, këta qytetarë edhe sot e kësaj dite nuk e kanë të zgjidhur problemin e ujit.

Qytetarët e Orllanit me rrethinë që nga viti 2012 kanë kaluar nëpër një numër të madh të institucioneve, edhe të nivelit lokal, edhe të atij qendror, edhe nëpër disa komisione parlamentare të Kuvendit të Kosovës dhe që nga ajo kohë, edhe sot e kësaj dite, nuk e kanë të zgjidhur këtë problem.

Ju e dini shumë mirë që përveç çështjes së problematikës së ujit, këta qytetarë nuk e kanë të zgjidhur edhe problematikën e ujërave të zeza, e cila problematikë tash së fundi, vitin e kaluar, si duket ka marrë një qasje dhe një kah të zgjidhjes si problem, por problem jetik për këta qytetarë, edhe sot e kësaj dite, mbetet uji i pijshëm.

Faktikisht, qytetarët e lokaliteteve të Orllanit me rrethinë e kanë jetike zgjidhjen e këtij problemi dhe nga këtu unë do të kërkoja, në radhë të parë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të gjejë mundësi që në periudhën e rishikimeve buxhetore, që do të bëhet tash së shpejti, ta ndajë një shumë mjetesh, në mënyrë që këtyre qytetarëve t'u zgjidhet problemi i ujit të pijshëm, i cili është problem jetik për këta qytetarë.

Sigurisht se, përveç kësaj, në momentin që do të ketë mundësi, të zgjidhet edhe çështja e ujërave të zeza, sepse ato ujëra të zeza, ju e dini shumë mirë që drejtpërdrejt janë të lidhura dhe drenohen në drejtim të Liqenit të Batllavës, nga i cili furnizohet pjesa më e madhe e qyteteve të Kosovës.

Prandaj, mendoj se është momenti i fundit që kjo situatë të merret me seriozitetin më të madh, edhe nga niveli lokal, edhe nga niveli qendror, dhe qytetarëve të Orllanit me rrethinë t'u zgjidhet problematika e ujërave të pijshëm. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem se potpredsednice Parlamenta!

Poštovane kolege poslanici,

Poštovani građani,

Želim govoriti o jednom važnom strateškom nacionalnom cilju Bošnjaka, odnosno o procesu lokalne samouprave, odnosno o decentralizaciji, dobijanju jedne nove opštine, Rečane, koja ispunjava sve adekvatne kriterijume od strane Ministarstva za lokalnu samoupravu, koje se traže od nas.

To je jedno geografsko područje, jedno nacionalno područje, koje ispunjava sve te ekonomske elaborate koje se traže, kako bi jedna normalna opština mogla da funkcioniše.

Poštovani građani,

Naime mi smo ovaj proces lokalne samouprave, odnosno proces decentralizacije i dobijanja nekih naših novih opština izgubili 2006. Godine tokom pregovora u Beču, a to je ostavljeno da kosovske institucije to reše. Međutim, i dan danas to se nije dogodilo. S obzirom da dolazim iz kraja koji zadovoljava sve te kriterijume, mi smo obavili službene posete predsedniku Republike Kosova, gospodinu Hashim Thaçi, i dobili javnu podršku, obavili sastanak sa našim premijerom Vlade, gospodinom Isom Mustafom, i takođe dobili javnu podršku, i on nas je obavestio da će formirati radni tim, odnosno ekspertsku grupu, koja će biti posvećena da uradi studije ekonomske izvodljivosti u narednom periodu.

Ovom prilikom želim takođe da se zahvalim i međunarodnom faktoru, koji nam od samog starta daje podršku, ali specijalno želim da se zahvalim i Američkoj ambasadi, sa kojima smo u stalnom kontaktu oko ovog procesa lokalne samouprave. Zašto nam je to važno? Iz razloga zato što govorim da je to ekonomski, privredni i prirodni potencijal, da govorim o većim kapitalnim ulaganjima u tom kraju, da govorim o onome što mi kao zajednica ispunjavamo i u nacionalnom smislu, ali pre svega želim da utičem na mnjenje, na širi auditorijum da nam je to prelepo geografsko područje, jako važan faktor za veću zaposlenost naših ljudi tamo i zaustavljanja emigracije.

Sve sam ovo govorila u cilju informisanja naših građana, a u razgovoru sa našim premijerom Vlade, koji mi je obećao da će u što skorijem vremenskom periodu formirati radnu grupu, mi ćemo te korake dostaviti i u pismenoj formi Ministarstvu za lokalnu samoupravu, i čekamo novog ministra, koji će se baviti time. Zahvaljujem!

KRYESUESJA: Faleminderit! Tani kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Të nderuar deputetë,

Siç po e vëreni, është mungesë e madhe e ministrave dhe nuk e di nëse keni kujt t'ia drejtoni këto pyetje. Sidoqoftë, në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare është 60 minuta. Aktualisht, për këtë seancë janë parashtruar gjithsej 20 pyetje parlamentare.

Po filloj të ju thërras me radhë, ashtu siç edhe parashihet në bazë të Rregullores.

Deputeti Salih Salihu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesuese!

Autostrada “Arbër Xhaferi” Prishtinë - Hani i Elezit po i vazhdon punimet, por në këtë autostradë nuk është paraparë të kyçet komuna e Vitisë, në fshatin Gërlicë, por qytetarët e saj duhet të shkojnë edhe 4 kilometra mbrapa, në fshatin Doganaj, për t'u kyçur në autostradë.

Qytetarët e komunës së Vitisë janë shumë të shqetësuar për anashkalimin që po u bëhet atyre. Për këtë arsye, opozita së bashku me shoqërinë civile, bashkësitë fetare, si dhe Asambleja Komunale e Vitisë kanë marrë për bazë shqetësimet e drejta të qytetarëve të saj dhe e ka ngrehur këtë çështje në të gjitha nivelet, duke filluar nga Kuvendi i Kosovës, Kuvendi Komunal i Vitisë dhe nëpër medie. Por, përgjigjet nga deklaratimet publike të kryeministrit Mustafa dhe ministrit Zharku ishin se kjo gjë nuk mund të bëhet.

Megjithatë, kohëve të fundit në mediet e shkruara u shpërnda një lajm se kryeministri dhe ministri Zharku po e shqyrtojnë mundësinë e kyçjes së Vitisë në Gërlicë.

Pyetja për kryeministrin është: Zoti kryeministër, a mund të na thoni se a do të kyçet Vitia në autostradën nëpërmjet fshatit Gërlicë dhe nëse po, ju si Qeveri kur do ta merrni vendimin zyrtar për këtë, pasi konsideroj se është nevojë urgjente të vendoset sa më parë, në mënyrë që të fillojnë punimet për kyçjen në Gërlicë të komunës së Vitisë, për ta zënë hapin në përputhshmëri të plotë me planin dinamik të punës me përfundimin e autostradës. Faleminderit!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar deputet!

Ne e kemi diskutuar këtë çështje me Ministrinë e Infrastrukturës, edhe sa i përket kyçjes së Vitisë, edhe sa i përket kyçjes së Ferizajt. Jemi marrë vesh që Ministria e Infrastrukturës ta bëjë një plan dhe t'i shohë mundësitë më të mira racionale të kyçjes, meqenëse kyçjet tani nuk janë të parapara në projektin me të cilin po ekzekutohet autostrada, të vijnë me një propozim të tillë në

Qeveri, në mënyrë që atë propozim ta miratojmë në Qeveri, në qoftë se propozimi i plotëson kushtet ligjore dhe standardet e autostradave të tilla dhe pastaj, me rishikimin e buxhetit të sigurojmë edhe mjete shtesë, meqenëse këto mjete nuk janë të parapara në buxhetin dhe me kontratën e ndërtimit të autostradës, mirëpo duhet të bëhen në mënyrë shtesë, që të parashohim këtë dhe në mënyrë shtesë të ekzekutohen këto punime.

Është biseduar edhe me kontraktuesin “Bechtel&Enka” që gjatë ekzekutimit të rrugës të na mundësohet që kjo çështje të realizohet. Prandaj, unë shpresoj që këtë do ta bëjmë, por Ministria e Infrastrukturës tani po punon që të na ofrojë propozimin lidhur me këto kyçje. Është e vërtetë se kjo nuk përkon shumë me standardet, sepse janë shumë të afërta hyrje-daljet në autostradë, por po ashtu është e vërtetë kjo ju që po thoni se ka kërkesa të arsyeshme nga të dy palët, edhe nga Komuna e Vitisë, edhe nga Komuna e Ferizajt, për kyçje të tilla.

Unë tani nuk mund të them konkretisht se kur do të bëhet kjo, sepse po presim që Ministria e Infrastrukturës të vijë me propozim, mirëpo në momentin që të vijë ne do ta trajtojmë në Qeveri dhe do ta konsiderojmë sipas interesit publik atë çështje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë? Po, e keni fjalën.

SALIH SALIHU: Po zoti kryeministër, mirëpo unë jam duke i përcjellë punimet aty në Gërlicë dhe mendoj se në qoftë se tash nuk parashihet dhe bëhen punë për të mos u kyçur aty Vitia dhe mandej, në qoftë se pas një muaji merrni vendim si Qeveri për ta kyçur Vitinë, domethënë kjo do të kushtojë shumë më shumë, sepse do të ketë ndryshime në plan.

Unë mendoj që si kryeministër duhet t’i përshpejtoni procedurat, meqë ju jeni përgjegjës dhe ta ftoni ministrin Zharku, në mënyrë që të bëhet kjo analizë sa më shpejt dhe të nisin punimet në përputhshmëri me kohën, sepse të bëhet punë dy herë është shumë më e kushtueshme për Qeverinë. Ndërkaq, për nivelin e rëndësisë, besoj se tanimë e keni kuptuar edhe ju si Qeveri, sepse nuk është fjala vetëm për komunën e Vitisë, por kjo e ndihmon edhe Gjilanin, edhe Kamenicën, por njëkohësisht edhe Ferizajn, për arsye se Ferizaj, një qytet kaq i madh, të lihet vetëm me një kyçje, është po ashtu e padrejtë.

Mendoj se kjo u hyn shumë në punë fshatrave të Ferizajt, sidomos Komogllavës, e keni aty Varoshin, por edhe Gërlica, si dhe Begraca, që është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Zoti kryeministër, dëshironi ta merrni fjalën?

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Unë vetëm dëshiroj të konfirmoj edhe një herë se ne kemi kërkuar nga ministria që ata ta adresojnë te “Bechtel&Enka” këtë kërkesë.

Janë disa procedura që ne i kemi jo shumë të këndshme me ta në këtë situatë, sepse po kërkojnë që kontrata të ekzekutohet ashtu siç është nënshkruar dhe do ta kemi parasysh këtë, do të intervenojmë prapë, në mënyrë që kyçja të sigurohet, në të vërtetë të sigurohet hapësira në të cilën ne mund ta bëjmë kyçjen më vonë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Puhie Demaku, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Nuk është këtu. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Pyetja ime për kryeministrin Mustafa është: Nga cili vit e ka filluar punën Komisioni Qeveritar për Demarkacionin e kufirit të Kosovës me Malin e Zi? Në cilin vit, pra, e ka filluar punën ky komision?

KRYESUESJA: Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I lashë letrat, meqenëse i kam të përgatitura këto përgjigje, janë mjaft shumë.

Komisioni e ka filluar punën në mars të vitit 2012. Komisioni për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi ka punuar nga marsi i vitit 2012 deri në vitin 2015. Mund të them se kur unë kam ardhur në krye të Qeverisë e kemi gjetur punën gati krejtësisht të përfunduar. Janë dhënë edhe tri raporte ose informata nga komisioni lidhur me gjendjen se ku ata janë dhe lidhur edhe me trajtimet edhe të disa informatave përfundimtare.

Kam kërkuar nga komisioni që të gjitha ato t'i sqarojnë me të gjithë banorët edhe me katër komunat, të cilat kufizohen me Malin e Zi, me komunën e Deçanit, Junikut, Pejës dhe të Istogut, dhe të mos na mbetet asnjë çështje e pasqaruar. Në qershor të vitit 2015, komisioni ka deklaruar se e ka përfunduar tërësisht punën dhe se nuk ka asnjë dokument, i cili ka mbetur edhe më tutje të trajtohet dhe të vlerësohet ndryshe nga ajo që ka vlerësuar komisioni.

Para se të shkojmë, kemi pasur edhe një bisedë me një numër të përfaqësuesve të asaj zone, në mënyrë që jemi munduar që edhe në prani të komisionit t'i trajtojmë ato dhe përfundimisht ka ardhur propozimi i komisionit në Qeveri, i cili ka qëndruar pas raportit lidhur me shënimin e vijës kufitare në mënyrë ligjore dhe në mënyrë profesionale.

Do të thotë, komisioni është caktuar është prej marsit të vitit 2012 dhe ka punuar gjatë asaj periudhe.

KRYESUESJA: Pyetje shitesë?

TETUA HAXHIU: Faleminderit!

Pyetja ime shumë shkurt ishte: Në cilin vit e ka filluar ky komision punën? Se, për të tjerat, kryeministër, ju kemi dëgjuar shumë herë. Ju kemi dëgjuar edhe atëherë kur i keni quajtur ekspertët shkencorë “të sëmurë psikikë”. Por, unë para vetes kam dy atlase gjeografikë shkollorë, në të cilët mësojnë fëmijët tanë, mësojnë nxënësit tanë, ku autor është Murat Meha.

Një atlas gjeografik, i cili është ribotuar katër herë dhe së fundmi, në maj të vitit 2015, e që kufirin saktë e njeh tamam ku kanë thënë ekspertët dhe ku thotë në vazhdimësi opozita, edhe shumica e pozitës, besa edhe qytetarët, pra në Kullë dhe në Çakorr. Pra, atlas i ribotuar katër herë, e autor është Murat Meha, që ju e keni si...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministren Dhurata Hoxha. Deputete, dëshironi ta lexoni pyetjen meqë ministrja... Fjalën e ka kryeministri, edhe pse nuk pati pyetje.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Dëshiroj të them se sa u përket atllaseve, unë s’jam redaktor i atllaseve dhe s’merrem me to. Do të thotë, ata që i kanë hartuar ato publikime, ata qëndrojnë dhe e kanë përgjegjësinë e autorësisë për ta, ashtu siç e kanë përgjegjësinë e autorësisë edhe për raportin për shënimin e vijës kufitare.

Ndërkaq sa i përket deklaratës për “të sëmurë psikikë”, kjo është deklaratë jotja, nuk është imja.

KRYESUESJA: Deputete, dëshironi ta lexoni pyetjen për ministren Dhurata Hoxha?

TEUTA HAXHIU: Desha ta pyes edhe kryeministrin, a është i sëmurë psikik Murat Meha?

Kurse për pyetjet, normalisht se ka dy muaj që i kam bërë këto pyetje dhe shumë herë nuk marrim përgjigje. Ne po i bëjmë pyetjet, sepse janë me rëndësi ngase qytetarët na i sjellin këto pyetje.

Sa i përket ministres, pyetja ime është: Gjykata dhe Prokuroria në pjesën veriore të Mitrovicës, ndoshta edhe kryeministri na përgjigjet, a funksionojnë dhe a janë të vendosura në ndërtesa shtetërore apo në ndërtesa private?

Ka më shumë se një vit që ndahen mijëra euro në muaj, më shumë se 12 mijë euro për ato objekte, dhe i kushtojnë shumë Buxhetit të Kosovës. A funksionojnë a nuk funksionojnë, dhe a janë të vendosura në objekte shtetërore apo private?

Mirë është që qytetarët ta dinë, sepse punët nuk kryhen, nuk funksionojnë ato objekte, kurse Buxhetit të Kosovës i kushtojnë me qindra mijëra euro. Është buxheti i qytetarëve, prandaj edhe qytetarët kanë nevojë të dinë, pra ta marrin një përgjigje, qoftë nga ministrja apo edhe nga kryeministri, ndoshta është i gatshëm.

KRYESUESJA: Deputeti Salih Salihu, pyetje për ministrin Blerand Stavilecin. Doni ta lexoni pyetjen?

SALIH SALIHU: Nënkyetare,

Pyetja i është drejtuar ministrit Stavileci, por ai nuk qenka këtu. Por, megjithatë, është me interes të përmendet që ka të bëjë me ndërmarrjen “Eco-higjiena”, që është në Gjilan dhe e cila merret me mirëmbajtjen dhe me mbeturinat e Gjilanit, Vitisë, Kamenicës. Në këtë rast, është duke u bërë padrejtësi e madhe, sepse kjo ndërmarrje nuk po i kryen obligimet konform premtimeve që i ka bërë, kur është bërë ndërmarrje me partneritet publiko-privat.

Pyetjen po e shtyj për herën tjetër, kur të vijë ministri.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Atëherë, edhe pse e morëm një përgjigje nga kryeministri, unë pyetjen e kam parashtruar më 28. 2. 2017, morëm një përgjigje për banorët e qytetit të Vitisë me fshatrat përreth, po ashtu edhe për fshatrat Komogllavë, Begracë, Varosh, Gërlicë dhe Greme, që ta kenë një kyçje më të afërt në fshatin Gërlicë.

Pyetja ime ka qenë e parashtruar kështu: Është njoftuar opinioni se ndërtimi i rrugëve Gjilan - Prishtinë dhe Gjilan - Ferizaj do të realizohet me katër korsi, kurse punimet do të fillojnë në muajin maj. Në vitin 2013, bizneset në qytetin e Ferizajt janë ftuar për konsultim në lidhje me ndërtimin e rrethrotullimit tek ura e madhe në Ferizaj, dhe në atë kohë projekti ka qenë që rrethrotullimi të ndërtohet në sipërfaqe të tokës. Dhe, të gjitha bizneset janë dakorduar për shkak se nuk janë cenuar interesat e asnjë biznesi, po ashtu ka pasur qasje të papenguar në rrethrotullim.

Ndërsa tashmë projekti ka nisur që rrethrotullimi të vendoset në lartësi mbi to. Sipas këtij projekti, bizneset nuk do të kenë mundësi ta zhvillojnë veprimtarinë afariste, kur dihet se këtyre personave të bizneseve u janë dashur 30 vjet që të arrijnë deri këtu, si dhe 250 punëtorë do të mbeten pa punë.

Pyetjen do ta përsëris edhe kur të jetë ministri i Infrastrukturës këtu. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputete, e keni edhe një pyetje për ministrin Arban Abrashi, doni ta lexoni, meqë ministri nuk është këtu?

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Tregova në fillim se këto pyetje i kam parashtruar në muajin shkurt, prandaj po e lexoj.

Para disa muajve është diskutuar për një marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Postës së Kosovës, me të cilën Posta merr përsipër shpërndarjen e skemave sociale apo ndihmave sociale në rreth 160 zyra postare anekënd territorit të Kosovës.

Sindikata e Postës ka treguar se sa do të kursente Qeveria po qe se nënshkruhet marrëveshja për shpërndarjen e skemave sociale nga bankat private te postat e Kosovës. Nëse ndihmat sociale shpërndahen përmes postës, e jo nga bankat private, kjo do të ishte në favor dhe e dobishme për ministrinë, Qeverinë dhe përfituesit e ndihmave sociale.

Pyetjen do ta përsëris edhe në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Edhe pse s'është ministri, po e lexoj pyetjen. Ka të bëjë me një problem, i cili vazhdimisht po përcillet te institucionet e Republikës së Kosovës, pothuajse në shumë fusha, që ka të bëjë me mosnjohjen e stazhit të punës nga vitet e okupimit dhe largimit me dhunë nga e drejta legjitime e punës, në vitet '89-'99, konkretisht për një kategori, për ish-policët, të cilët janë larguar me dhunë, apo edhe në aspektin vullnetar, që të mos i nënshtrohen regjimit të Milosheviqit pas vitit 1989. Kjo kategori edhe sot e asaj dite ka mbetur e kushtëzuar me 15 vjet të përvojës së punës, që për mua është diskriminim në raport me ata që kanë vazhduar të punojnë në institucionet e ish-dhunës ta quaj ashtu, apo të Serbisë, dhe sot e gëzojnë këtë benefit.

Andaj, edhe me ligj është e rregulluar, por është rregulluar për disa kategori dhe terminologjia juridike që është përdorur dhe të tjerët që kanë punuar në institucionet e Republikës së Kosovës, kjo ka mbetur akoma, si duket, e pazbatueshme.

Pyetja ime është: Deri ku ka arritur ministria ta rregullojë këtë të drejtë dhe si është duke e trajtuar këtë kategori apo individët, që të mos u mohohet kjo e drejtë për ta gëzuar stazhin kontributdhënës.

KRYESUESJA: Deputet, e keni po ashtu edhe një pyetje për ministrin Memli Krasniqi, i cili mungon. Doni ta lexoni pyetjen?

ARMEND ZEMAJ: Po i lexoj pyetjet për shkak se ato janë parashtruar shumë më herët, por për shkak të lëvizjeve të seancave dhe kësaj gjendjes së re të kalendarit të tyre...

Pyetja ka të bëjë me ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: Në prill të vitit 2015 është arritur marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Komisionit Evropian për zbatimin asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Kosovën në kuadër të instrumentit të asistencës së para-anëtarësimit IPA, komponenti i pestë për zhvillimin rural në Republikën e Kosovës, i quajtur IPARD. Duke marrë për bazë kohën e kaluar prej 2 vjetësh nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, e cila i siguron vendit tonë mjete të konsiderueshme financiare, i jam drejtuar me këtë pyetje: Deri ku ka arritur me implementimin e obligimeve të marra si institucione përgjegjëse për ta menaxhuar këtë asistencë të dobishme financiare në kuadër të instrumentit të asistencës së parazgjerimit të IFA-s. Këtë pyetje e shtrova, sepse kjo është kërkuar edhe nga takimet që i kemi me ata që i japin këto fonde dhe që kanë shprehur shqetësim për mosimplementimin e marrëveshjes, sidomos në aspektin e sferës së bujqësisë, e cila është shumë e rëndësishme për vendin tonë. Arsyeshmëritë edhe ata pothuajse tash duket që i kanë marrë vesh, sepse jo gjithçka shkon në rregull me shpërndarjen e fondeve, sidomos në sferën e bujqësisë.

KRYESUESJA: Deputeti Faton Topalli ka pyetje për ministrin Ferat Shala. Deputet, a do ta lexosh pyetjen?

FATON TOPALLI: Po, dua të shtroj një problem, i cili ka të bëjë me fshatrat Komogllavë dhe Gurëz, ku ndodhet një deponi transiti. Prej hapjes së kësaj deponie në vitin 2004 deri më sot nuk ka funksionuar asnjëherë. Deponia kundërmon dhe liron gazra, pra e ndot edhe ambientin dhe është problem për fshatrat Komogllavë dhe Gurëz.

Pas një proteste të Lëvizjes “Vetëvendosje” të qytetarëve të atij rrethi kjo deponi ka funksionuar vetëm për një muaj. Megjithatë, pas këtij muaji kanë kaluar prapë disa muaj e më gjatë dhe nuk është bërë deponia funksionale. Aty kundërmojnë plehrat, të cilat i pengojnë banorët e fshatit Komogllavë dhe banorët e fshatit Gurëz. Pyetja ime për ministrin ka qenë: A e njihni këtë problem, çfarë keni ndërmarrë dhe çfarë do të ndërmerrni për ta zgjidhur atë?

KRYESUESJA: Deputeti Mytaher Haskuka ka pyetje për ministrin Ferat Shala. Doni ta lexoni pyetjen?

MYTAHER HASKUKA: Me të vërtetë ky Kuvend e ka humbur kuptimin e tij, kur çdo pyetje është më e vjetër se një muaj, dhe në shumë raste, domethënë ministrat nuk janë këtu për t’iu përgjigjur pyetjeve, por janë nëpër fushata zgjedhore së bashku me kryeparlamentarin. Unë dua ta lexoj pyetjen, sepse pastaj kalon edhe afati i saj.

Sipas Ligjit nr. 04/ L- 027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, neni 2, pika 2, cakton që shteti është përgjegjës për organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si sistem unik dhe integral shtetëror. Po ashtu, sipas nenit 4, pika 1, detyrat themelore të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera janë: zbulimi i monitorimeve dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Në këtë aspekt, duke u bazuar në këto pika të ligjit, në lagjen Rexhaj në fshatin Korishë të Prizrenit që nga viti i kaluar ka rrëshqitje të dheut dhe aty një lagje e tërë është e rrezikuar nga rrëshqitja e dheut. Disa shtëpi tanimë kanë dëmtime strukturale në beton dhe këto familje janë të detyruara të flenë te të afërmit, ngase nuk kanë siguri në shtëpitë e tyre. Për këtë gjendje asamblastët e Lëvizjes “Vetëvendosje” në Komunën e Prizrenit kanë paralajmëruar dhe kanë kërkuar intervenim urgjent, por shumë pak është bërë deri më tani dhe gjendja është përkeqësuar gjatë dimrit. Duke pasur parasysh që tani vijnë edhe shirat e pranverës, kjo mund të rrezikojë këtë lagje dhe mund të ketë viktima. A jeni në dijeni për gjendjen në këtë lagje dhe rrezikun që u kanoset qytetarëve nga rrëshqitja e dheut? Nëse po, cilat janë veprimet që ka ndërmarrë Qeveria për sigurinë e qytetarëve dhe për mbrojtjen e tyre nga fatkeqësitë natyrore sipas ligjit të lartshënuar?

Unë shpresoj që para se të ketë viktima, Qeveria të intervenojë në këtë lagje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Shqipe Pantina ka pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, nënkryetare!

Edhe pse ministri nuk është këtu, është kryeministri dhe nëse nuk përgjigjen në pyetje, shpresoj se do të mendojnë ta zgjidhin problemin.

Aeroporti i Prishtinës me siguri është ndër të vetmit në Evropë për ku nuk ka transport publik. Qytetarët ose duhet të shkojnë me veturat e tyre, ose të paguajnë taksë, që prej Prishtinës është 15 euro deri në aeroport. Pyetja ime për ministrin Zharku ka qenë: Pse nuk ka një apo më shumë kompani të licencuara që do të ofronin transport publik për në aeroportin e Prishtinës? Përderisa kemi taksë të licencuar, por jo autobusë dhe prapë po them, shpresoj që edhe pse nuk është këtu për t’u përgjigjur, do të merren seriozisht dhe do ta zgjidhin këtë problem. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Faton Topalli ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

FATON TOPALLI: Faleminderit! Unë kam shtruar shumë pyetje për kryeministrin Mustafa dhe asnjëherë nuk është përgjigjur deri tani. Pyetje ime që kam shtruar është e vjetër, unë shpresoj të më përgjigjet. Besoj, zoti kryeministër, që ju jeni në dijeni për ankesat e shumta të qytetarëve

dhe pjesëtarëve të shoqërisë civile për rrogat e larta të deputetëve, ministrave, kryeministrit apo drejtorëve të bordeve në ndërmarrjet publike.

Rroga mesatare në Kosovë është 375 euro, në sektorin privat janë shumë më të ulëta rrogat se sa këtë që përmenda. Zakonisht ju bëni krahasim me rajonin dhe unë dua të bëj një krahasim me Zvicrën. Zoti kryeministër, rroga bazë e një deputeti në Kosovë është 1 mijë 490 euro, respektivisht 17 mijë e 800 euro në vit, pa llogaritur këtu mjetet shtesë. Nuk e di nëse dini, por rroga bazë e një deputeti në Zvicër është 2 mijë e 025 euro në muaj, apo 24 mijë e 300 euro në vit. Kur kësaj i shtohet edhe shtesa për seanca, komisione e të tjera, deputetët zviceranë fitojnë diku 60 mijë euro, por vetëm 18% më shumë se mesatarja e vendit, e cila në Zvicër është 50 mijë e 300 euro.

Besoj që e kuptoni se ku dua të dal. Deputeti në Kosovën e varfër fiton 400% më shumë se qytetari me rrogë mesatare, ndërsa deputeti në Zvicrën e pasur fiton vetëm 18% më shumë se mesatarja e të ardhurave në vend, respektivisht jo më shumë se një mësues, jo më shumë se një mekanik, apo moler. Unë dua t'ju pyes, zoti kryeministër, si do të arsyetoni para qytetarëve diskrepancën e madhe mes rrogave mesatare të qytetarëve dhe rrogave të zyrtarëve të lartë që janë 400% më të mëdha sesa ato të mesatares së vendit?

Si kryeministër i vendit dhe përfaqësues i shumicës parlamentare do të duhej të kujdeseshit që dallimi mes rrogës mesatare të qytetarëve dhe rrogës së zyrtarëve të lartë të ishte më i vogël. Çfarë e keni ndërmend të bëni në këtë drejtim?

KRYESUESJA: Fjalën e ka kryeministri.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Kjo çështje si e tillë konsideroj që meriton vëmendje dhe meriton zgjidhje, sepse kemi diferenca shumë të mëdha të pagave në Kosovë dhe këto diferenca nuk janë në harmoni me punën dhe përgjegjësinë në punë dhe se shumë njerëz në Kosovë, edhe në shërbimin civil, në shërbimet profesionale, edhe në nivelet politike nuk paguhen njëjtë për punën që e bëjnë.

Punët e njëjta nuk kanë shpërblim të njëjtë. Ne jemi munduar, sepse është punuar mjaft gjatë në Ligjin për pagat që të adresojmë këtë çështje dhe të sigurojmë së pari që te punonjësit e administratës shtetërore të gjithë të barazohen me pagat në harmoni me punën dhe me përgjegjësinë që e kanë. Të vlejë rregulla që për punë të njëjtë, të jenë edhe pagat e njëjta. Po ashtu, jemi munduar që të bëjmë edhe një harmonizim sa i përket nivelimit vertikal, prej pagës së presidentit të vendit që konsiderojmë se duhet të jetë paga më e madhe, pagës së kryeparlamentarit dhe kryeministrit dhe pagave të tjera, prej pagave të drejtuesve ose shefave ekzekutivë të kompanive publike, të cilat nuk kemi arritur t'i futim në këtë ligj, sepse duhet të bëhen ndryshime edhe në Ligjin mbi ndërmarrjet publike, të agjencive të pavarura, qofshin ato

që i përgjigjen Kuvendit ose Qeverisë së Republikës së Kosovës, sepse ka laramani të papërbalueshme në paga.

Ne e kemi tërhequr Ligjin për pagat nga procedura para dy javësh, në marrëveshje me Komisionin Evropian, sepse është kërkuar që ky ligj të trajtohet së bashku me Ligjin e shërbimit civil dhe me Ligjin mbi organizimin e administratës shtetërore dhe mendojmë që këto së bashku t'i trajtojmë në një pako të ligjeve dhe t'ia ofrojmë Kuvendit diku para vjeshtës së këtij viti në trajtim. Sa i përket pagës së deputetëve dhe mënyrën se si ju e prezantoni atë në krahasim me deputetët zviceranë ose deputetët e tjerë, të gjithë ne jemi këtu, ju vendosni vetë për pagat tuaja me shumicën e votave, nuk vendos Qeveria as kryeministri për pagat e deputetëve. Ne do të ekzekutojmë si Qeveri çdo vendim që Kuvendi i Republikës së Kosovës e merr në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, a keni pyetje shtesë?

FATON TOPALLI: Zoti kryeministër,

Mendoj që përgjegjësinë për rritjen e nivelit të rrogave mesatare e bart Qeveria, pra është edhe përgjegjësi juaja që kemi kaq rroga të vogla në mesatare. Unë do të doja të dija, ju e keni tërhequr ligjin, a do të ndryshonte Ligji për pagat diferencën e madhe prej 400% mes rrogës mesatare dhe rrogës së zyrtarëve të lartë.

KRYESUESJA: Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Ne si Qeveri e kemi përgjegjësinë për pagat e sektorit publik, pagat që paguhen nga buxheti i Republikës së Kosovës. Ne si Qeveri nuk e kemi përgjegjësinë për paga në kompanitë publike, sepse ato janë të pavarura në pikëpamje të menaxhimit financiar të tyre dhe ne kemi kompani publike kur punonjësit mesatarë të këtyre kompanive publike e kanë pagën mesatare sa të një ministri të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e kanë mbi 1 mijë euro, sa e ka ministri ose të tjerët e kanë 5 herë rrogën më të madhe se sa që e kam unë si kryeministër i vendit, si drejtor ekzekutiv i tyre kompanive, sepse unë kam pagën diku 1 mijë e 450 euro, ata e kapërcejnë pagën 6 mijë dhe 7 mijë euro, gjë që në pikëpamje të parimeve ne duhet këtë çështje ta rregullojmë.

Ne nuk i rregullojmë edhe pagat e sektorëve privatë, sepse ato varen, por ajo çfarë ne kemi bërë si Qeveri, është që kemi propozuar ta ndalim trendin e rritjes së pagave në sektorin publik dhe nuk kemi pasur rritje gjatë këtij mandati, përpos që kemi pasur rritje mbi bazën e përvojës së punës prej 0,5% në vit, do të thotë që mesatarisht flitet për një rritje prej 6% të pagave në mënyrë që të kemi një afërsi më të madhe mes sektorit publik dhe sektorit privat, sepse njerëzit po ikin nga sektori privat për të shkuar në sektorin publik, për arsye se pagat janë shumë më atraktive në

sektorin publik se sa në sektorin privat. Ndërkaq ne duhet të bazohemi në ekonominë private, sepse ajo është ekonomi bartëse e zhvillimit ekonomik.

Prandaj, ne do të bëjmë përpjekje maksimale që t'i racionalizojmë, të themi, këto diferenca dhe t'i biem në përmasa të arsyeshme, por nuk mund të them se Qeveria mund t'i bëjë vetë ato, sepse ne nuk vendosim për sektorin privat, nuk vendosim për sektorin e kompanive publike, për arsye se ato vendosin vetë, në qoftë se ky Kuvend nuk bie ligj. Unë jam për atë që Kuvendi të bjerë ligj, me të cilin ne do t'i kufizojmë edhe pagat te kompanitë publike, edhe te agjencitë e pavarura, sepse është totalisht e paarsyeshme që të kemi diferenca të tilla. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Salih Morina ka pyetje për ministrin Avdullah Hoti.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetare!

Ministria e Financave me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 06/22, datë 3. 4. 2015, shtojca 2, është caktuar si institucioni përgjegjës kryesor për nëntë kapitujt e Programit kombëtar për zbatimin e MSA-së. Ky program përmban gjithsej 1374 masa, prej të cilave 304 janë legjislative dhe 1070 të tjera masa zbatuese. Vetëm rreth 55% e tyre janë përmbushur plotësisht, ndërkaq 11,43% janë në proces të zbatimit dhe 33% të tjera janë në stadi të mëvonshme të përmbushjes.

Pyetja për ministrin: Specifikisht, a mund të na thoni, cilat janë pengesat me të cilat përballlet Ministria e Financave në plotësimin e 9 kapitujve që i ka në përgjegjësi? Meqë dihet se plotësimi apo mosplotësimi i disa kapitujve varet edhe nga marrëdhëniet që i zhvillojmë me vendet e rajonit.

KRYESUESJA: Po, zoti ministër, urdhëroni! E keni fjalën.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesuese e seancës!

I nderuar deputet, ju falënderoj për pyetjen!

Ju njoftoj edhe një herë që Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është nënshkruar më 27 tetor 2015 nga kryeministri Mustafa dhe nga zonja Mogerini. Kjo marrëveshje tash vendos një kornizë të marrëdhënieve të Kosovës me BE-në.

Ministria e Financave, në bazë të vendimit të Qeverisë së datës 3.4.2015 në shtojcën 2 është caktuar si përgjegjëse për nëntë kapituj në kuadër të Programit kombëtar për zbatimin e MSA-së. Në vitin 2016 Ministria e Financave ka qenë përgjegjëse për 23 masa legjislative dhe 21 masa zbatuese. Mbi 90% të këtyre masave ne kemi arritur t'i përmbysim si Ministri e Financave. Kemi punuar me një përkushtim të madh.

Ne si Ministri e Financave në veçanti jemi përgjegjës për bllokun e dytë, që ka të bëjë me kriteret ekonomike. Në këtë fushë ne kemi arritur të sigurojmë qëndrueshmërinë ekonomike dhe fiskale të vendit dhe t'i përmbushim të gjitha kriteret që janë kërkuar në kuadër të MSA-së. Ju njoftoj se gjatë vitit 2016, ashtu siç kam raportuar edhe herëve të tjera në Kuvend, kemi performuar jashtëzakonisht mirë të hyrat, të cilat janë rritur me 12%. Kemi vendosur masa të kontrollit të shpenzimit në përgjithësi, në veçanti të shpenzimit korentë.

Është mirë që kriteret, të cilat kërkohej në kuadër të MSA-së, të korrespondojnë edhe me kriteret e përcaktuara me programin e FMN-së. Rrjedhimisht, ne e kemi përmyllur vitin 2016 me një deficit shumë më të ulët sesa limiti i përcaktuar me ligj prej 2% të GDP-së.

Viti 2017 ka filluar jashtëzakonisht mirë. Ne e kemi dorëzuar në janar Programin e reformave ekonomike në Komisionin Evropian, që është kërkesë edhe e MSA-së, brenda së cilës ne i përcaktojmë reformat vjetore që ndërmerr Qeveria e Kosovës në relacion me Komisionin Evropian. Tash po punojmë në kornizën afatmesme të shpenzimeve për 2018/2020, e cila në detaje do t'i parashohë masat që do të ndërmerren në kuadër të MSA-së, si Ministri e Financave në veçanti.

Sa u përket marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare, në Ministrinë e Financave ne jemi përgjegjës për kapitullin 29 të 'acquis communautaire', që është Unioni Doganor. Ju njoftoj që është arritur progres, në veçanti me anëtarësimin e Doganave të Kosovës në Organizatën Botërore të Doganave më 3. 3. 2017, pastaj edhe të lëvizja e lirë e kapitalit jemi bërë anëtar i EGMOND Group, që është rrjet ndërkombëtar i njësisve të inteligjencës financiare.

Te blloku i tretë, që janë standardet evropiane të 'acquis communautaire', ju njoftoj që Kuvendi e ka miratuar Ligjin për ndihmë shtetërore, i cili është përgatitur në konsultim me Komisionin Evropian. Tash po punohet në përgatitjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Po punojmë në përputhje me direktivat e BE-së në ligjin e ri për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Kemi nxjerrë rregulloret e brendshme për kontrollin e financave publike, në përputhje me ligjin që është miratuar në Kuvendin e Kosovës vitin që shkoi. Te shërbimet financiare Banka Qendrore është duke punuar shumë në nxjerrjen e rregulloreve për qeverisjen korporative të bankave, rregulloren për vlerën e kontributeve pensionale, rregulloren për mjetet e pensioneve dhe vlerësimin e mjeteve të pensioneve.

Në fushën e prokurimit publik, që është pjesë e reformave dhe pjesë e MSA-së, ju njoftoj që kemi aprovuar listën e artikujve për përdorim të përbashkët më 24. 2. 2017 në Qeveri, nëpërmjet një Udhëzimi të ri administrativ. Kemi aprovuar Strategjinë kombëtare për prokurim publik

2017/2021, që parasheh veprimet konkrete të secilit institucion që ka të bëjë me prokurimin publik. Po zbatojmë prokurimin elektronik në të gjitha institucionet qendrore dhe lokale.

Pra, këto janë obligimet që ka Ministria e Financave në kuadër të MSA-së dhe Planit kombëtar për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, a keni pyetje shtesë? Atëherë, fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi, ka pyetje për ministren Hykmete Bajrami.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zonja ministre,

Shoqata e Naftëtarëve të Kosovës ka deklaruar se brenda një dite në Kosovë hyjnë rreth 2 milionë litra karburante, por sipas tyre, një sasi e vogël i nënshtrohet kontrollit të cilësisë në kufi. Bazuar në pohimin e ministrisë suaj, gjatë vitit 2016 nga 580 mostra që janë marrë në pikat shitëse të naftës me pakicë, 46 mostra nuk kanë qenë konform standardeve të parapara me Udhëzimin administrativ të ministrisë. Numri i mostrave të kontrolluara në krahasim me sasinë që importohet është i vogël, rreth 10% i numrit të mostrave, që nuk do të thotë se është 10% i sasisë së karburanteve që nuk i plotëson standardeve.

Ky fakt është shqetësues, edhe nëse vërtet janë vetëm 10% të karburanteve që s'i plotësojnë standardet.

Zonja ministre, çka ka ndodhur me derivatet që nuk i kanë plotësuar standardet? Janë nxjerrë këto derivate nga tregu, apo është lejuar përdorimi i tyre, shitja e tyre? Çka është ndërmarrë ndaj importuesve të derivateve të dëmshme për shëndetin e qytetarëve, besa edhe për xhepin e tyre? Faleminderit!

KRYESUESJA: Zonja ministre e ka fjalën.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Kurteshi,

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që nga fillimi i mandatit, në fakt e kemi pasur me prioritet rregullimin e tregut të naftës.

Ke parashtruar pyetje edhe vitin e kaluar dhe ju kemi njoftuar me disa nga punët, të cilat ne i kemi bërë në fillim të mandatit. Ju kemi treguar, gjithashtu, se kemi gjetur 50% të pikave të karburantit që kanë qenë pa licencë, kemi ndërmarrë aksionin e licencimit të tyre. Sot vetëm 7% të pikave të karburantit në Kosovë, që janë aktive, janë pa licenca. Shumica prej këtyre pikave janë si rezultat i kontratave të qiramarrjes që kanë me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës dhe

Ligji në fuqi për rregullimin e tregut të naftës, në fakt kërkon që kontratat e qirasë të jenë minimumi dyvjeçare.

I kanë plotësuar të gjitha kushtet. Është kushti i vetëm, po punojmë me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës që ta adresojmë edhe këtë çështje. Në fakt, për herë të parë në këtë mandat kemi arritur të licencojmë edhe pikat e karburantit në komunat e Leposaviqit, Mitrovicës Veriore, Zveçanit dhe Zubin Potokut.

Kemi marrë gjithsej vitin e kaluar 580 mostra. Përqindjet që i dhatë janë të sakta. Është interesante që ankesa vjen nga Shoqata e Naftëtarëve, sipas ligjit në fuqi dhe legjislacionit komplet në fuqi, janë pikërisht naftëtarët dhe importuesit e të gjitha mallrave në Kosovë, që janë të obliguara me ligj për të sjellë produkte kualitative në vend, derisa ata nuk i sjellin dhe mandej ankohen përse importin e karburantit nuk e bëjnë ministritë, po e bëjnë veçanërisht, domethënë, jo shoqatat, po përfaqësuesit e shoqatave.

Ne i kemi marrë 580 mostra. Ashtu siç e thatë, 92,1% e tyre kanë dalë konform, 7,9% e tyre kanë dalë jokonform. Prej këtyre 46 mostrave që kanë dalë jokonform, vetëm 12 prej tyre kanë pasur problem sulfurin, ndërsa të tjerat janë 32 për pikën e ngrirjes dhe disa të tjera për densitetin dhe indikatorë të tjerë.

Ne nuk e kemi konfiskuar karburantin që ka dalë jokonform, sepse as nuk kemi rezervuarë si shtet dhe nuk kemi bazë ligjore që na mundëson konfiskimin. Janë gjobat e parapara monetare, që ne i shqiptojmë, pastaj lënda kalon në gjykatë. Për të gjitha këto lëndë janë duke u trajtuar në gjykatë. Disa prej tyre edhe janë mbyllur. Në fakt, me ligjin e ri për rregullimin e tregut të naftës ne kemi paraparë që pikat e karburantit, të cilat shesin naftë jocolësore, komplet t'ua konfiskojmë licencat e operimit të tyre, në mënyrë që ato të përjashtohen nga ky treg, në mungesë të kapaciteteve për t'i konfiskuar këto derivate.

Ne, vitin e kaluar kemi blerë pajisje mobile, të cilat për shkak të problemit të kalibrimit do të qëndrojnë në ministri dhe do të bëjmë teste, me anë të të cilave ne nuk do të...

(Ndërprerje nga regjia)

Por, në qoftë se karburanti sipas analizave tona del jokonform, ne do t'i dërgojmë lëndët në super analizë, në mënyrë që pastaj të vijmë deri te gjobat reale.

Më lejoni t'ju tregoj se edhe kur jam përgjigjur në vitin 2015 jua kam bërë me dije që legjislacioni sekondar nuk ka qenë në harmoni me legjislacionin primar. Na ka marrë shumë kohë që të harmonizojmë legjislacionin. Kemi nxjerrë Udhëzimin Administrativ 2017/1, i cili kalon kompetencën e kontrollit të cilësisë nga trupat inspektuese te Dogana e Kosovës. Kjo është

në harmoni me Ligjin e konformitetit, Kodin doganor dhe të akcizave, si dhe me Ligjin për rregullimin e tregut të naftës. Në fakt, më 23 prill, në mënyrë efektive, kompetenca nga trupat inspektuese kalon te Doganat e Kosovës.

Jemi duke biseduar me ministrin e Financave, besoj që ose para rishikimit të buxhetit, ose në rishikim do të ndahen 1 milion euro, në mënyrë që ne të pajisim laboratorin e Doganave të Kosovës me të gjitha pajisjet për kontrollin e cilësisë së karburanteve dhe ky të vlejë si një laborator shtetëror. Ne, në fakt, kemi pasur një cikël të operatorëve privatë, të cilët e kanë kontrolluar njëri-tjetrin. Absolutisht edhe ne si përfaqësues të institucioneve nuk kemi qenë të kënaqur me punën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, pyetje shtesë? Po!

ISMAJL KURTESHI: Po! Sipas kësaj që thatë, zonja ministre, çfarëdo kualiteti hyn këtu brenda në vend shitet, dëmtohet shëndeti i qytetarëve dhe dëmtohen xhepat e tyre.

Kur e keni ndërmend që nafta që hyn këtu, e që është e dëmshme për qytetarët, që nuk është konform standardeve, të mos lejohet të shitet dhe të mos lejohet të hyjë në vend fare?

Se çfarë masash duhet të merrni është çështje juaja, por nëse lejohet një gjë e tillë, atëherë ju jeni përgjegjës, jo vetëm për dëmin material, por edhe për dëmin që shkaktohet në shëndetin e njerëzve. Domosdo, përgjegjësia ju bie juve, jo Shoqatës së Naftëtarëve, ata i kanë interesat e veta, kurse ju i mbron interesat e qytetarëve. Faleminderit!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Po, është shumë e vërtetë që është përgjegjësia jonë, por më lejoni t'ju rikujtoj se është edhe përgjegjësi e deputetëve, të cilët e nxjerrin legjislacionin. Ligjin e fundit të cilin e kam tërhequr, e kam tërhequr për arsyen e vetme, sepse janë bërë amendamentet sipas kërkesës së Shoqatës së Naftarëve dhe unë jam në mbrojtje të qytetarëve në këtë rast dhe jam detyruar ta tërheq ligjin.

Kështu që kur të vijë ligji, përkraheni ligjin, bashkërisht i bëjmë masat për kontrollin e cilësisë.

KRYESUESI: Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti kryeministër,

Si pasojë e vendimeve të papërgjegjshme të kësaj Qeverie, Buxheti i Kosovës me vendimin e Tribunalit Ndërkombëtar të Arbitrazhit është dëmtuar gjer më tani mbi 35 milionë euro. Telekomit i Kosovës “Vala” duhet t'i paguajë rreth 30 milionë euro “Devolli Group”, kurse

kompanisë austriake në lidhje me tenderin e pasaportave të Ministrisë së Punëve të Brendshme nga Buxheti i Kosovës duhet t'i paguhen 5,3 milionë euro.

Zoti kryeministër, për këtë dëm të madh që i është shkaktuar Buxhetit të Kosovës nuk mund të mos ketë përgjegjës dhe përgjegjësi, dhe përgjegjësit lehtë mund të identifikohen.

A i keni iniciuar hetimet për këto raste? Nëse po, a janë identifikuar personat përgjegjës dhe a janë përcjellë rastet në Prokurori për këtë dëm të madh që i është shkaktuar Buxhetit të Kosovës nga Qeveria e Kosovës, ose pjesë të Qeverisë së Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESJA: Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit për pyetjen, zoti deputet Kurteshi!

Tash, unë vetëm dëshiroj të përkufizohem se këto dëme nuk janë dëme që i janë krijuar Buxhetit të Kosovës me vendime të papërgjegjshme të kësaj Qeverie, sepse problemet datojnë ashtu siç datojnë dhe kanë të bëjnë me vendimmarrës të ndryshëm.

Unë sot kam kërkuar edhe një herë informatë prej PTK-së lidhur me gjendjen që ka të bëjë me vendimin e Arbitrazhit në llogari të kompanisë “Dardafon” dhe unë po jua prezantoj informatën siç e kam marrë. Do të thotë se konform vendimit të Bordit të Drejtorëve të Telekomit, të datës 28 dhjetor 2016 dhe konform procedurës së zhvilluar të prokurimit dhe pas angazhimit të ekspertëve ekstere-ligjorë të kompanisë “Patern Boks” në Londër, nga ana e tyre si përfaqësues ligjorë të Telekomit, është ngrehur padi në gjykatën kompetente në Londër, Britani e Madhe, për ta sfiduar vendimin parcial që është marrë nga Arbitrazhi.

Bazuar në faktin se selia e Arbitrazhit ka qenë në Londër, atëherë pa marrë parasysh se seancat e shqyrtimit kryesor të Tribunalit janë mbajtur në Vjenë të Austrisë, formalisht konsiderohet se vendimi i Tribunalit mund të sulmohet në Gjykatën Nacionale të Britanisë së Madhe, në Londër. Seanca kryesore në këtë rast është mbajtur në Londër, më 3 prill 2017, dhe pas shqyrtimit nga gjykata, iniciativa e Telekomit të Kosovës kundër vendimit të pjesërishëm dhe vendimit kryesor është refuzuar. Prandaj, sipas kësaj, mbetet në fuqi vendimi paraprak, i cili e ngarkon Telekomin e Kosovës që të paguajë rreth 30 milionë euro në llogari të “Dardafonit”, që edhe për mua është një vendim tepër i rëndë dhe një vendim që kërkon përgjegjësi të veçantë, pa marrë parasysh nëse ato mjete do të paguhen nga Telekomit i Kosovës, ose nga Buxheti, sepse Telekomit i Kosovës është në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ne jemi aksionarë të Telekomit të Kosovës, prandaj me këtë po humb prona publike për 30 milionë euro. Po ashtu, jam informuar se është ngrehur padi për anulimin e vendimit të Arbitrazhit në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Është iniciuar propozimi për ngritjen e kërkesës

për mbrojtjen e ligjshmërisë të prokurori i shtetit. Kjo iniciativë në ndërkohë është mbështetur nga prokurori i shtetit dhe janë iniciuar veprimet adekuate ligjore për rastin dhe është duke u kundërshtuar vendimi për njohjen e vendimit të Arbitrazhit në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Sa i përket adresimit të pyetjes konkrete, jam informuar se gjatë muajit janar 2017, sipas kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, nga Policia e Kosovës, Drejtorja për Hetime të Krimeve Ekonomike dhe të Korrupsionit është iniciuar hetimi që ndërlidhet me rastin e vendimit të Tribunalit Ndërkombëtar të Arbitrazhit sipas rregullave të ITC-së, i cili hetim ka të bëjë me dyshimet për keqpërdorim të pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Hetimet janë duke u zhvilluar dhe korporata është duke bashkëpunuar në maksimum me zyrtarët hetues të Policisë së Kosovës në drejtim të ndriçimit të rastit, konform dispozitave dhe kërkesave ligjore. Do të thotë, kjo është gjendja që është tani duke u zhvilluar.

Ndërkaq, sa i përket rastit të pasaportave, kur buxheti në mënyrë të drejtpërdrejtë dëmtohet me 5 300 000 euro, ju e dini, se është një aktgjykim i gjykatës për dënimin e tetë personave. Personat është thënë publikisht se cilët janë ata të dënuar, do të thotë Natali Velijaj, Fisnik Blakaj, Betim Blakaj, Ergyn Dogani, Ymer Fazlija, Nazmi Thaçi, Jakup Blakçori, Sefedin Shala e të tjerë, mirëpo dënimi i tyre nuk e kompenson dëmin që i është krijuar Buxhetit të Kosovës, sepse është fjala për një dëm mbi pesë milionë euro, i cili duhet t'i paguhet kompanisë së Austrisë për shtypjen e pasaportave, edhe përkundër asaj se është paguar një herë kjo, mirëpo paratë nuk kanë shkuar në llogari të kompanisë, por kanë devijuar dhe janë abuzuar në formë tjetër.

Prandaj, unë do të angazhohem maksimalisht si kryeministër që të zhvillohen të gjitha procedurat ligjore, që ata që e kanë shkaktuar dëmin, e që është dëm shumë i madh, të përgjigjen para ligjit dhe po ashtu që përgjegjësia të adresohet në mënyrë konkrete për këto, sepse nuk ka askush të drejtë të përfitojë në formë të tillë nga paratë publike, qoftë nga Buxheti i Kosovës, qoftë nga kompanitë publike. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë? Po!

ISMAJL KURTESHI: Është e vërtetë që vendimmarrësit janë të ndryshëm, po janë të të njëjtit koalicion, të këtij koalicioni aktual, prandaj përgjegjësia bie mbi koalicionin dhe një pjesë e atyre që janë përgjegjës për këtë janë pjesë e Qeverisë që ju e udhëhiqni.

Nëse gjykatat po i zvarritin vendimet, çka keni ndërmarrë ju si kryeministër që ata që një herë kanë abuzuar me buxhet, së paku të mos kenë përgjegjësi në Qeverinë e Kosovës, të lirohen nga ato pozita, ose edhe të ndërmerret ndonjë masë. A ka diçka të atillë nga ju personalisht, si kryeministër, që keni ndërmarrë, sepse disa herë keni deklaruar se në Qeverinë që ju e udhëhiqni

nuk ka afere korruptive, e tash po del se ka, bile shumë afere korruptive, edhe këto të mëhershmet, edhe këto të fundit. Faleminderit!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Po aferat, zoti Kurteshi, nuk janë çështje të trashëgimisë, sepse çdonjëri përgjigjet për punët, për veprimet dhe për aferat e veta. Edhe kjo Qeveri do të përgjigjet për të gjitha përgjegjësitë ligjore që i ka për parane publike dhe për vendimet të cilat i merr. Prandaj, në qoftë se ju keni ndonjë argument që në këtë Qeveri kemi individë që janë bartës të keqpërdorimeve ligjore, të abuzimit të parasë publike, të aferave, do të ishin shumë të mirëseardhura që ato t'i thoni, qoftë në Kuvend, qoftë të na informoni ose ne, ose Prokurorinë.

Ndërkaq, çështjet tjera janë çështje në të cilat nuk mund të ndërhyjmë ne si Qeveri në procedura ligjore, sepse edhe për rastin e pasaportave, edhe për rastin e Telekomit janë duke u zhvilluar procedura. Ato procedura do të zhvillohen në mënyrë ligjore. Në momentin që adresohen fajtorët, ose individët, në qoftë se ata janë punonjës, qoftë drejtpërdrejt të Qeverisë, ose të institucioneve tjera, ne do të marrim masa që ata të përgjigjen për ato punë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Salih Morina, pyetje për ministrin Avdullah Hoti.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetare!

Komunat e Kosovës, ndonëse përballen me një buxhet modest, ato po hasin në vështirësi të ndryshme për ta shpenzuar në masë më të madhe buxhetin e tyre.

Pyetja për ministrin është: Cilat janë veprimet që po i ndërmerr Ministria e Financave që komunat të jenë më të kujdesshme në formën e shpenzimit të parasë publike dhe a mund të na prezantoni mesataren e shpenzimit të buxhetit për projektet kapitale nga komunat gjatë vitit 2016?

KRYESUESJA: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesuese e Kuvendit!

I nderuar deputet,

Më lejoni të ju informoj që menaxhimin financiar Ministria e Financave edhe për komunat e bazon në Ligjin e financave publike. Bazuar në këtë ligj ne e përgatisim kornizën afatmesme të shpenzimeve, e cila është në fuqi për 2017-2019. Tash jemi duke e përgatitur kornizën e re dhe gjatë muajit prill vjen në Kuvend.

Bazuar në këtë kornizë, ne nxjerrim qarkoret buxhetore edhe për komunat, ku specifikojmë zërat buxhetorë, ku duhet të shpenzohen mjetet dhe pastaj, bazuar në ato qarkore dhe pas dëgjimeve buxhetore, ne e dorëzojmë në Kuvendin e Kosovës Ligjin e Buxhetit, ku janë të specifikuar të gjitha shpenzimet që ndodhin në nivel komunal.

Pastaj është çështje e auditimit të brendshëm fillimisht dhe auditimit të jashtëm nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të parë nëse janë kryer shpenzimet nëpër komuna në përputhje me Buxhetin e aprovuar në Kuvendin e Kosovës.

Sivjet, siç e dini, ne e kemi bërë edhe një avancim në këtë drejtim duke zbatuar planifikimin pesëshifror të Buxhetit, që përveç ndarjes në kategori mallra, shërbime kapitale e të tjera, ne brenda këtyre kategorive shkojmë me pesë nivele dhe ju do të keni mundësi, që duke filluar nga tremujori i parë i këtij viti, të shihni në detaje se si po shpenzohet Buxheti.

Për pjesën e dytë të pyetjes suaj, ju njoftoj që Buxheti për projekte kapitale për vitin 2016, në nivel komunal është realizuar në nivelin 85%, prej tyre ka pasur një përqindje më të lartë të shpenzimeve nga grandet qeveritare në 96%, ndërkaq nga të hyrat vetjake 72% janë shpenzuar për shpenzime kapitale.

Ka pasur variacion bukur të madh ndërmjet komunave. Komunitat që kanë performuar më së miri janë Vitia, Kllokoti, Peja, Graçanica, Skenderaj, Vushtrria, Gjilani, Juniku dhe Deçani. Unë i kam informatat detaje për secilën komunë, për nivelin e shpenzimeve të grandeve qeveritare dhe të të hyrave vetjake. Nëse keni interesim mund t'ju dorëzoj personalisht dhe e shihni komunë për komunë nivelin e shpenzimeve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetë, keni pyetje shtesë? Atëherë, deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministren Dhurata Hoxha. A doni ta lexoni pyetjen?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, se edhe ashtu pyetjet po barten prej seancës në seancë, në mungesë të Ekzekutivit. Kjo është papërgjegjësi që ministrat të mos jenë nëpër këto seanca.

Pyetja ka të bëjë me një raport që e ka dhënë ministrja e Drejtësisë gjatë raportimit në Komision Parlamentar, kur pati deklaruar se Ministria e Drejtësisë e ka prioritet respektimin e të drejtave të njeriut. Në fakt, sa herë që Qeveria deklarohet se e ka prioritet një sektor, del e kundërta, domethënë që nuk respektohet fare ai sektor. Edhe në Kosovë s'po respektohen të drejtat e njeriut.

Ne kemi pasur shumë ankesa. Në këtë rast kemi pasur ankesa nga të burgosurit, që nuk po trajtohen ashtu siç e meritojnë të trajtohen, sepse, në fund të fundit, edhe ata janë njerëz dhe meritojnë të trajtohen. Rastin që dua ta veçoj në këtë rast është rasti i ish-komandantit të Shtabit të Përgjithshëm, ish-komandantit të FSK-së dhe ish-ambasadorit të Republikës së Kosovës në Tiranë, i cili këto ditë për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore nuk po lejohet që të marrë trajtim shëndetësor. Kjo nuk është në rregull, sepse edhe pse të burgosur duhet të respektohen të drejtat e të burgosurve dhe të drejtat e njeriut.

Unë mendoj se Qeveria dhe ministria në këtë rast duhet t'i trajtojë njerëzisht të gjithë të burgosurit që mbahen nëpër burgjet e Kosovës.

KRYESUESJA: Dhe, pyetja e fundit është e deputetes Blerta Deliu-Kodra për ministrin Kujtim Shala. Si duket, as deputetja e as ministri nuk janë këtu.

Tani, përfunduar me këtë pikë të rendit të ditës për të vazhduar me të tretën:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seanca e mëparshme

Dhe, në mungesë të kuorumit, atëherë shkojmë në pauzë e kthehemi në orën 14:30.

Ju lutem, kini vëmendjen, në orën 14:30 të jini këtu në seancë.

* * *

Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë,

Jemi 25 minuta pas kohës së caktuar për vazhdimin e seancës. Aktualisht në sallë janë 37 deputetë dhe besoj se nuk janë as kushtet minimale, që të vazhdohet me këtë seancë. Atëherë, në këtë çast e mbyllim këtë seancë dhe ju njoftojmë për vazhdimin e seancës pas mbledhjes së Kryesisë.

* * *

E martë, më 18 prill 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 11 prill

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zoti zëvendëskryeministër,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 prill 2017.

Fillojmë me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si në vijim:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seanca e mëparshme

Nëse ka dikush vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 9, 14, 15, 27 shkurt dhe 2, 9, 10 mars 2017, mund të paraqiten. A ka dikush vërejtje? Nuk ka.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 9,14,15,27 shkurt dhe 2,9,10 mars 2017.

4. *Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale*

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj që në seancat e kaluara për votimin e kësaj pike nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Andaj në seancën e sotme e riprocedojmë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. (s'e ka numrin hiç).

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Mirë, e shtyjmë, e lëmë për tjetër herë. Pasi ju keni kohë, edhe ne kemi kohë. Sa herë të doni, mos e bëni kuorumin.

5. *Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”*

E dini që në seancat e kaluara nuk ka pasur kuorum sa i përket votimit të kësaj rezolute. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, Votojmë tash!

Edhe kjo nuk ka kuorum.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Diskutimi për këtë projektligj ka përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 10 mars 2017. Në seancën plenare të mbajtur më 31 mars 2017 është proceduar për votim amendamenti numër 1 i këtij projektligji, por nuk është miratuar.

Procedimi i mëtutjeshëm për votimin e amendamenteve të tjera të këtij projektligji në mungesë të kuorumit është shtyrë. Andaj, sot procedojmë me votimin e amendamenteve prej 2 deri në 15 të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL. Fillojmë me votimin:

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Në sallë janë 74 deputetë. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

A ka dikush pa kartelë? Një pa kartelë.

Atëherë, konstatoj se 67 deputetë me kartelë kanë votuar, një pa kartelë, bëjnë 68 deputetë.

63 deputetë kanë votuar për. Asnjë kundër. Katër abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Faleminderit!

7. Shqyrtimi i Propozim-Programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017

Programi i Punës i Kuvendit për vitin 2017 është hartuar në bazë të Programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017, planeve të punës së komisioneve parlamentare, Programit kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe agjendës evropiane për reforma evropiane për vitin 2017.

Programi i Punës paraqet një dokument bazë për aktivitetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si organ ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues. I ftoj përfaqësuesit e komisioneve parlamentare, nëse e kërkojnë fjalën? Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kryetari e ka fjalën, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar. E mbështesim plotësisht, nëse ndërkohë do të ketë iniciativa dhe kërkesa të tjera, ne jemi të gatshëm për plotësimin eventual. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Zoti nënkryetar, edhe ne si Grup Parlamentar e mbështesim këtë Program të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën në fjalë, domethënë për vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zonja Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Sot është data 18 prill dhe jemi pothuajse në përfundim të sesionit pranveror të punës së Kuvendit dhe ne vetëm sot po e shqyrtojmë Programin e Punës për vitin 2017, çka do të thotë se pjesa e parë, apo sesioni pranveror tashmë ka përfunduar. Ky program do të duhej të vinte në dhjetor, atëherë kur edhe shqyrtohet buxheti dhe të lihet hapësirë e mjaftueshme edhe për deputetët që t'i japin propozimet e veta, por edhe si çdo projektligj, e sidomos ato të rëndësishme, edhe ky nuk e ka pasur vëmendjen e duhur të atyre që e kanë hartuar. Dhe, unë nuk e di kush e ka hartuar, e ka përmbledhur këtë program, sepse nuk është program i hartuar, por edhe kështu siç e ka bërë, them të drejtën, është një punë më shumë e një filloristi se sa e një profesionisti apo grupi profesionistësh që e kanë hartuar këtë program.

E para, qysh në faqet e para të programit nuk ka shpjegim se çfarë synon ky Kuvend të arrijë gjatë këtij viti, apo thjesht, do ta luajë rolin e makinës votuese, e cila siç e pamë këtë mëngjes, edhe ashtu nuk po funksionon, bile as rolin votues të vet Kuvendi nuk është duke e kryer si duhet, sepse në shumicën e kohës deputetët, kryesisht të koalicionit qeverisës, edhe pse fizikisht janë këtu, nuk votojnë. Kështu që nuk e di pse ne duhet të hartojmë program, të cilin ne fare nuk e zbatojmë.

Po ashtu, faqja e parë është më shumë një përshkrim i punës që tashmë është e përcaktuar me Rregullore. Ta zëmë, një nga paragrafët e këtij programi thotë kështu: “Seancat plenare të Kuvendit mbahen zakonisht dy herë në muaj”. Nëse është kështu, tashmë ky program nuk është zbatuar, sepse për këta tre muaj që kanë kaluar të këtij viti ne nuk e kemi zbatuar këtë program. Java plenare thotë fillon ditën e enjte, edhe ajo asnjëherë nuk është zbatuar. Tashmë dihet se agjendën e sesionit plenar e përcakton Kryesia, kështu që nuk e di pse duhet të thuhet në këtë program.

Po ashtu, puna e Kuvendit nuk është ajo që bëhet vetëm në këtë sallë plenare. Kur e kemi diskutuar dhe e kemi miratuar buxhetin e Kuvendit, jo buxhetin në tërësi të Qeverisë, nga objektivat atje, ta zëmë, e cila fare nuk figuron këtu, është rritja e bashkëpunimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës me, ta zëmë, kuvendet e ndryshme të shteteve, me të cilat tashmë kemi

krijuar edhe grupe të miqësisë, ajo nuk figuron fare në këtë Program. Do të thotë, a synojmë ne që përveç miratimit të ligjeve, raporteve të ndryshme që vijnë nga Qeveria, t'i kemi edhe disa çështje, disa pika, të cilat ne si Kuvend i bëjmë vetë.

Një çështje tjetër, e cila fare nuk është përfshirë në këtë program është, ta zëmë, bashkëpunimi me shoqërinë civile. Tashmë Kuvendi ka themeluar një grup, i cili quhet “Forumi për bashkëpunim me shoqërinë civile”, ka bile edhe një plan pune atje, por i cili nuk është fare pjesë e Programit të tërësishëm të Kuvendit. Ose, një nga synimet e këtij Kuvendi, të paktën të kësaj legjislature, ani pse nuk po zbatohet fare, përkundrazi ka degradim në këtë çështje, është rritja e transparencës së punës së Kuvendit, e cila po ashtu nuk pasqyrohet fare në këtë program. Në fakt, siç thashë, kemi pasur degradim, sepse shumë shpesh kohët e fundit mbledhjet e komisioneve të ndryshme, sidomos kur ka pasur çështje me interes për publikun, ato janë mbyllur fare për publikun, duke mos i lënë mediat të bëhen pjesë e saj.

Ngjashëm është po ashtu roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë. Ne e dimë që pyetjet parlamentare janë pjesë të secilës seancë, ani pse nuk po ndodh prapë në praktikë. Mirëpo, a duam ta rrisim ne këtë rol, kur ankesat më të mëdha, kritikrat më të mëdha me të drejtë, si nga shoqëria civile, organizatat vendore, por po ashtu edhe nga partnerët ndërkombëtarë, e besa edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian jepen për faktin se Kuvendi nuk po e zbaton si duhet rolin e vet mbikëqyrës karshi Qeverisë dhe në këtë program nuk shihet asnjë synim, asnjë përpjekje për ta forcuar këtë rol, sepse nuk parashihet as edhe një aktivitet i vetëm.

Siç thashë, puna e Kuvendit nuk bëhet vetëm në këtë sallë dhe nuk bëhet vetëm në mbledhje të komisionit. Janë dëgjimet publike, nëpërmjet të cilave ne e përfshijmë publikun, gjegjësisht grupet e interesit në vendimmarrje, nuk pasqyrohet aspak në këtë program. Janë tryezat e tjera, të cilat ky Kuvend do të duhej t'i organizonte, në fakt, mungojnë edhe në praktikë, por edhe në këtë program. Pra, si përfundim, ky Program më shumë është një punë e një filloristi i cili krejt çka ka bërë është ka marrë strategjinë legjislative, por edhe disa dokumente të tjera, të cilat do të duhej të shqyrtohen nëpër seanca, por assesi nuk paraqet Programin e Punës së Kuvendit, prandaj si të tillë unë i ftoj deputetët që të mos e votojnë, por të hartohet një grup, i cili në kuadër të Kryesisë apo grup profesional, i cili do të hartonte një Program siç duhet për Kuvendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Muharremaj e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2017, për neve është i bartur prej vitit 2016 ky program. Është një program i vonuar dhe kemi

ardhur në përfundim që Grupi Parlamentar i Aleancës nuk do ta votojë këtë program. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma” e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Edhe ne si “Nismë” e kemi shqyrtuar dhe analizuar Programin e Punës së Kuvendit. Më vjen keq, por duhet të them se Programi i Punës tregon gjendjen e mjerueshme në të cilën është institucioni i Kuvendit si rezultat i koalicionit të papërgjegjshëm dhe ne jorastësisht, domethënë në këtë plan nuk kemi të përcaktuar prioritetet që i ka kjo Qeveri dhe ky koalicion.

Në anën tjetër, faktikisht janë më se dy vjet që disa nga ligjet që nuk miratohen në Kuvend dhe që janë rezultat i moskoordinimit të partnerëve të koalicionit nuk janë vënë në skemën prioritare të miratimit, kur e dimë se mungesa e atyre ligjeve ka krijuar hendikep në fusha të ndryshme.

Natyrisht se Kuvendi duhet të ketë program të punës, por të miratohet programi i punës në muajin e katërt, kjo tregon shumë qartë se ku jemi dhe sa është serioz ky Kuvend. Tash unë nuk po flas për deputetët në mënyrë individuale, por ata që kanë përgjegjësi thjesht i kanë degraduar vlerat e institucionit më të lartë, kështu që ne nuk do të marrim pjesë në votimin e këtij programi të punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Melihate Tërmkollli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Unë do të përpiqem t’i them nja dy-tri fjalë rreth Programit të Punës së Kuvendit.

Në fakt, mendoj që ky program i punës është shumë më tepër një program që merret me teknika, e jo me politikë. Në fakt, Programi i Punës së Kuvendit do të duhej të ishte e kundërta. Do të duhej që të promovonte dhe të nxirrte ligje, të cilat promovojnë politika dhe zhvillojnë politika të caktuara në këtë vend.

Ne shohim që shumë nga këto ligje që janë paraparë këtu janë të vonuara dhe më tepër kemi plotësim-ndryshime sesa ligje të reja, që nuk do të thonë shumë në këtë drejtim. Kjo tregon një mungesë të madhe serioziteti edhe të Kuvendit, në radhë të parë të kryetarit të Kuvendit, i cili është gjithçka tjetër, përveç ushtruesi të funksionit të kryetarit të Kuvendit.

Ne kemi folur për disa ligje, të cilat nuk i pashë këtu në Programin e Punës së Kuvendit dhe unë propozoj që të jenë pjesë e Programit të Punës së Kuvendit.

1. Ligji për Memorialin e Presidentit Rugova dhe

2. Ligji për Gjykatën Administrative.

Sepse nuk mund të presim që Gjyqësori do t'i zgjidhë rastet nëse nuk e kemi themeluar edhe Gjykatën Administrative. Mendoj se është diçka shumë e domosdoshme.

Ne po flasim e po flasim, kurrë s'po ndalemi së foluri, për luftën kundër korrupsionit, por këtu nuk kam parë asnjë ligj që në njëfarë mënyre paraqet bazamentin e luftës kundër krimit dhe korrupsionit. Nuk është Ligji antimafia. Nuk e di pse edhe sa vjet nuk po vjen ky ligj në Parlament. Nuk është Ligji për dekriminalizimin e politikës dhe institucioneve publike dhe shtetërore. Kush po u ikën këtyre temave dhe këtyre çështjeve? Ku është Ministria e Drejtësisë? Ku është Qeveria? Ku është Parlamenti?

Llafe po bëjmë sa po duam, por punë konkrete reale nuk ka. Kështu që unë mendoj që ky program thjesht është tepër formal, nëse nuk merremi më seriozisht me trajtimin e shumë çështjeve, të cilat janë tepër të rëndësishme për funksionimin normal të institucioneve të shtetit dhe shoqërisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Po, jemi duke e shqyrtuar Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2017. Natyrisht se kam pritur që ky program i punës të jetë i arsyetuar nga ekspertët të fushave të ndryshme, të ketë qëllime të përcaktuara paraprakisht, të ketë shpjegime, e këto shpjegime të ndihmojnë pastaj sa u përket qëllimeve dhe thjesht t'i ndihmojnë deputetët që në bazë të një shpjegimi, ku jepen qëllimet, strategjia, të kenë mundësi ta votojnë pastaj edhe Programin e Punës.

Ajo që u tha deri më tash është kështu, që ne po votojmë për një plan i cili i takon së kaluarës, kanë kaluar katër muaj. Nisur nga kjo logjikë, ne do të mund ta votonim sot Planin e Punës për vitin 2015 dhe 2016, sepse i takon thjesht së kaluarës.

Tash, teksti që ne e kemi përpara nuk përmban asnjë fjalë lidhur me strategjinë dhe prioritetet që ka Kuvendi, madje asnjë fjalë për qëllimet. Pra, cilat janë qëllimet e Kuvendit për vitin 2017? A dëshiron Kuvendi i Kosovës ta mbikëqyrë më mirë Qeverinë sesa e ka mbikëqyrur deri më tash, respektivisht që nuk e ka mbikëqyrur fare. A e ka për qëllim bashkëpunimin me Parlamentet tjera? Cilat janë prioritetet në këtë bashkëpunim?

Mungon pastaj një analizë e vetë punës së Kuvendit, respektivisht nuk është shtruar si qëllim rritja e efektivitetit të punës së vetë Kuvendit. Kuvendi ka degraduar gati tërësisht edhe në mbajtjen e mbledhjeve të rregullta.

Ajo që ne e kemi para vetes janë thjesht konturat e punës së Kuvendit, por ky nuk është plan as serioz, as ambicioz, as i dinjitetshëm, për një organ, për një institucion siç është Kuvendi i Kosovës.

Ne i kemi përpara vetes vetëm disa tabela me projektligje, por edhe këto tabela me asnjë fjalë nuk janë arsyetuar. Pra, cilat janë ligjet me prioritet të Kuvendit të Kosovës? Pse janë radhitur ligjet kështu dhe nuk janë radhitur ndryshe? Pra, e kemi përpara një dokument, i cili na shitet si plan, por nuk është plan. Plani, normalisht, ka edhe qëllime të përcaktuara.

Nga dokumenti që e kemi përpara shohim një grumbull ligjesh, thjesht të hedhura në letër si grumbull, por asnjë qëllim të proklamuar dhe të definuar. Si Qeveri po punojmë pa plan, si Kuvend po punojmë pa plan. Pra, po punojmë me planet e së kaluarës. Nuk po e jetojmë as të tashmen, nuk po planifikojmë për të ardhmen, por thjesht po jetojmë në të kaluarën.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

TEUTA HAXHIU: Plani i punës, ashtu siç e thanë edhe kolegët, jo vetëm se ka ardhur me vonesë, por nuk është respektuar, në radhë të parë, nga Kryesia e Kuvendit, edhe pse do të duhej të ishte në vendin e vet në kryerjen e detyrave, për çka edhe i kanë marrë përgjegjësitë, duke filluar nga kryetari i Kuvendit, por edhe ju si nënkryetar i Kuvendit, sepse në të shumtën e rasteve keni qenë vetëm të shënuar në letër për pozitat çfarë i keni dhe asnjëherë nuk e keni kryer detyrën, të cilën është dashur ta kryeni.

Me gjithë mangësitë e Planit të Punës së Kuvendit, shumë herë Kuvendi, e kam thënë disa herë që Kuvendi do të duhej ta monitoronte Qeverinë e Republikës së Kosovës, por në këtë legjislaturë Qeveria e ka dedikuar punën e Kuvendit. Fatkeqësisht, një model jo i pranueshëm dhe nuk do të duhej të ndodhte, por në fakt ka ndodhur në këtë Qeveri dhe gjithçka është imponuar pikërisht nga Qeveria Kuvendit, në këtë rast në paaftësinë, do të thosha, e kryerjes së detyrave tuaja, si Kryesi e Kuvendit.

U përmend që jashtë funksionimit dhe detyrave që i ka Kuvendi, pra i kemi edhe grupet e miqësisë, siç e tha edhe Shqipja, ju si nënkryetar i Kuvendit keni edhe preferenca, keni pasur takime në Gjermani dhe keni pasur preferenca dhe keni dalë jashtë asaj për çka jemi grupe të miqësisë, sepse mbi të gjitha i kemi caktuar ne si subjekte politike dhe mua personalisht nuk më jeni përgjigjur as në pyetjen që jua kam drejtuar si nënkryetarit të Kuvendit dhe si kryetarit të grupit të miqësisë.

Prandaj, nuk i keni respektuar vendimet, nuk po i respektoni dhe normalisht dështimet e Kuvendit janë pikërisht si pasojë e juaja si Kryesi, por edhe e deputetëve të pozitës, që asnjëherë nuk kanë qenë të përgjegjshëm. Pra, po i shihni votimet, mosvotimet, prania e tyre dhe

mosvotimi i ligjeve me rëndësi, por edhe pikave shumë të rëndësishme po dështojnë pikërisht për shkak të jopërgjegjësisë dhe jo të kryerjes së detyrave për çka janë thirrur. Prandaj, do të duhej të reflektoni ndryshe dhe të mos vazhdoni kështu me abuzime, por thjesht ta kryeni detyrën, ose të tërhiqeni nga detyra dhe të mos e pranoni detyrën çfarë e keni.

KRYESUESI: S'po dua të bëj as replikë, as të polemizoj, por unë besoj që Kryesia i ka zbatuar të gjitha rregullat brenda kompetencave të saj, ashtu siç... Pse të ka mbetur ty hatri ndonjë send, unë s'mund të të kërkoj falje tash, kur të duash bisedojmë. Nuk është çështje për Parlament, besoj ajo që e ngrite. Por, sidoqoftë, nëse ty të ka ngelur hatri, të kërkoj falje. S'kam pasur tjetër mundësi sa i përket vizitës në Gjermani dhe unë e kam bërë në kuadër... është i vetmi grup i miqësisë që ka shkuar me ftesë, me listë emërore dhe me shpenzime sipas rregullave që i kanë grupet e miqësisë, i vetmi. Tjerat grupe kanë shkuar me shpenzime të Kuvendit të Kosovës dhe kanë shkuar pa ftesë zyrtare. Kështu që nuk është mirë të ngrihen çështje të cilat nuk i di dhe nuk janë në përputhje me rregullat e Parlamentit.

Por, unë nuk ju përgjigjem zakonisht juve kur më kritikoni dhe ai është problem imi. Unë s'e di ku është pyetja. Zonja Berisha e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë e mora fjalën për hir të opinionit publik, sepse të gjithë deputetët që janë këtu e dinë fort mirë se si hartohet Programi i Punës së Kuvendit, por për hir të atyre që na shohin dhe dëgjojnë, më lejoni që të shkëpus disa paragrafë nga ky Program i Punës së Kuvendit, të cilin sot po e shqyrtojmë.

Programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 paraqet dokumentin bazë për aktivitetin e Kuvendit si organ ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

Kërkoj vëmendje në këtë pasus: Hartimi i programit të punës është bazuar në këto dokumente, që realisht e dinë të gjithë deputetët; programi legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017; planet e punës së komisioneve parlamentare për këtë vit; Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së dhe reformat evropiane për vitin 2017.

Pra, ne nuk na takon të ankojemi shumë pse është i varfër apo i pasur ky program, sepse me Rregulloren e Punës së Kuvendit të gjithë deputetët kanë të drejtë të bëjnë nisma legjislative, të cilat nuk ua ndalon askush dhe ato nisma ta pasurojnë këtë program, të cilin sot po e shqyrtojmë dhe duhet ta miratojmë.

Në krejt këtë program janë dy nisma prej deputetëve dhe dy nisma prej komisioneve parlamentare. Pra, përveç Qeverisë që sjell strategji legjislative në Kuvend për ta miratuar, kemi të drejtë edhe ne si deputetë, por edhe ne si organe të funksionimit të Kuvendit, siç janë

komisionet parlamentare. Prandaj, çfarëdo që të themi, nuk është mirë të bëjmë me gisht dhe adresën e dështimit, pasurimit, varfërimit apo të këtij programi ta drejtojmë diku tjetër. Së pari, të kërkojmë më shumë nga vetvetja.

Edhe unë pajtohem se duhet të jetë një dinamikë më e përshpejtuar dhe më cilësore e punës së Kuvendit, por kjo dinamikë është e tillë kur jemi të gjithë bashkë si deputetë dhe nuk u japim ngjyrimë politike, nganjëherë edhe personale, punëve të cilat i kemi si obligim, që i kemi marrë si të tilla edhe nga qytetarët.

Ajo që ndoshta ne duhet ta diskutojmë është se këtu thuhet: për përmbushjen e programit të punës, Administrata e Kuvendit u ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit duke e përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës së këtij programi.

Nëse këtu e analizojmë këtë pjesë, mendoj se do të pajtoheni të gjithë se lë për të dëshiruar, sepse natyrisht që Administratës së Kuvendit i mungon ekspertiza. Ne kemi diskutuar edhe nëpër komisione parlamentare, por edhe nëpër grupe parlamentare dhe që të jetë ekspertiza në nivelin e duhur, sigurisht se duhet buxhet pak më shumë, ose t'i analizojmë format tjera, që deputetët të mbështeten edhe nga ana profesionale.

Mandej, në këtë program thuhet: “Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Qeverinë, e cila duhet t'i përmbahet programit legjislativ të Kuvendit për vitin 2017”.

Prandaj, unë konsideroj se ndoshta nuk është shumë korrekte që të debatojmë rreth saj dhe të përpiqemi t'ia hedhim fajin Kryesisë së Kuvendit, kryetarit apo dikujt tjetër. Që të zbatohet ky program duhet që të gjithë së bashku të punojmë, Kryesia e Kuvendit, deputetët, Qeveria...

Ajo që ndoshta ne si deputetë duhet të kërkojmë më së shumti, obligimin që e kemi menjëherë pas bërjes së ligjeve, mbikëqyrjen e Qeverisë, se sa po i zbaton ato ligje, apo ku janë pengesat? U përmend këtu nga një parafolës, Qeveria sa po mbikëqyret? Nuk po mbikëqyret aspak dhe ne duhet ta mbikëqyrim. Po, u përmend se po vijnë ligje për plotësim-ndryshim, ju e dini shumë mirë se ne jemi përcaktuar si Kuvend që ligjet t'i përafrojmë me standardet e Bashkimit Evropian dhe sa herë atje të ndryshojnë dokumentet, edhe ne duhet t'i hyjmë plotësimit dhe ndryshimit të ligjeve që t'i përafrojmë ose plotësisht t'i bëjmë në koordinim me dokumentet e Bashkimit Evropian, pra që edhe ligjet tona të jenë në harmoni me to.

Unë kërkoj që ta miratojmë, sepse edhe ashtu jemi vonuar, edhe ashtu komisionet parlamentare kanë filluar zbatimin e këtij programi para se të miratohet këtu, dhe dëshiroj të mos bëjmë lojë në këtë drejtim, por ju ftoj që ta votojmë dhe ata, të cilët, siç e përmendi edhe kryetari i Grupit

Parlamentar të PDK-së, ndërkohë që brenda këtij viti sigurisht që do të dalë ndonjë nismë legislative, e cila do t'i bashkëngjitet këtij programi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, Qeveria nuk ka ndonjë të dërguar për të dhënë mendimet e saj për këtë propozim-program.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Faleminderit! Kanë votuar 75 deputetë.
57 janë për. 14 kundër. 4 kanë abstenuar.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Programin e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Unë po propozoj që ta ndryshojmë pak radhën e ligjeve, t'i votojmë ligjet që janë në lexim të dytë me amendamente dhe pastaj ligjet dhe raportet sipas radhës.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbaremore

Në sallë janë 77 deputetë. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandojnë miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj deputetin Agim Ademaj, që në emër të Komisionit FunkSIONAL të paraqesë dhe të arsyetojë raportin me rekomandime.

Nuk ka nevojë kjo, kjo është e panevojshme, nuk ka kurrfarë nevoje që të raportojë askush për këtë. Raportet, shqyrtimi është bërë, kemi vetëm votimin e amendamenteve.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës, që janë 22 të paraqitura nga raporti i Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, ju ftoj që ta votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë 82 deputetë. Votojmë tash!

Kanë votuar 79 deputetë.

71 për. Asnjë kundër, 8 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-132 për automjete

Të nderuar deputetë, komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Në këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar 87 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës. A i votojmë përnjëherë të gjitha?

Atëherë, po i votojmë të gjitha në pako, domethënë nuk është askush kundër që t'i kalojmë.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, për t'i votuar të gjitha, domethënë 87 amendamentet në pako, të shqyrtimit të dytë të Projektligjit për automjete. Votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar 72 deputetë.
62 për, 3 kundër, 7 abstenime. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, tani me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar 80 deputetë.
68 janë për, 4 kundër, 8 kanë abstenuar.

Kuvendi e miratoi Ligjin për automjete.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës

Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar projektligjin e propozuar nga Safete Hadërgjonaj, e mbështetur nga 25 deputetë të Kuvendit dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Ftoj zonjën Hadërgjonaj, e cila s'qenka këtu. Përfaqësuesin e Qeverisë, nuk e di, Flora Brovina në vend të Safete Hadërgjonajt.

FLORA BROVINA: Faleminderit! Nuk flas në emër të Safetes, por në emër të Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Komisioni e ka shqyrtuar këtë projektligj të propozuar nga një grup deputetësh dhe më 1 mars 2017, pas shqyrtimit të hollësishëm, debatit që është zhvilluar në komision me tri vota për, 3 vota kundër, një abstenim dhe, besoj edhe një votë në mungesë, që është e kolegut Ali Berisha, i cili është nënshkruer i këtij grupi që e propozon ligjin, ne konsiderojmë se ligji nuk i mori votat në komision, por meriton të analizohet dhe të diskutohet në kuptimin gjithëpërfshirës, sepse është në interes të një popullate, e cila ka nevojë për këtë ligj.

Ne si komision në vazhdim kemi formuar edhe Grupin Punues, duke konsideruar se në këtë mbledhje, pas debatit do të marrë votën pozitive dhe do të vazhdojmë që të bisedojmë edhe me shoqërinë civile, e cila ka një përvojë për këto organizata dhe, natyrisht edhe me vendet, të cilat kanë suksese sa i përket ligjit të tillë. Ju faleminderit, besoj që diskutimi do të rrjedhë në kuptimin pozitiv që ligji të aprovohet, si kryetare e komisionit flas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Komisioni ka dhënë mendimin e tij për mosmiratimin e tij, propozuesja nuk është këtu dhe përderisa nuk është, ne e kemi praktikuar ndonjëherë edhe kur s'ka qenë Qeveria të flasë, por meqenëse propozuesja është deputete, mendoj që duhet ta shtyjmë për seancën e ardhshme që të ketë mundësi edhe ajo ta prezantojë ligjin.

Ose po e shqyrtojmë dhe po e votojmë, si të doni!

A ka dikush prej grupit të deputetëve propozues, i cili mund të diskutojë sa i përket çështjes së ligjit dhe ta shqyrtojë apo doni ta shtyjë për seancën tjetër?

S'do kurrkush që të diskutojë prej komisionit, atëherë e shtyjë për seancën e radhës ose në Kryesi e vazhdojmë diskutimin.

11. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021

Komisioni Funkcional për Integritet Evropian në bazë të nenit 62, paragrafi 1 dhe nenit 57, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë të paraqesë dhe ta arsyetojë programin, zonja Mimoza Ahmetaj.

MINISTRJA MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Deputetë të nderuar,

Më lejoni të paraqes para jush Programin Kombëtar të Republikës së Kosovës për zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim për periudhën 2017-2021.

Programi i hartuar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet zbatuese përmban masat afatshkurtra 1-vjeçare dhe prioritetet afatmesme 5-vjeçare që kanë për qëllim përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim. Përveç reformave kyçe, politike, ekonomike që kërkon Marrëveshja për Stabilizim-Asociim, Programi parasheh masa konkrete në kuadër të 33 kapitujve të 'acquis communautaire' të BE-së. Bazuar në strukturën e kritereve të Kopenhagës, të gjitha masat dhe prioritetet janë të ndara në tri blloqe dhe në 40 kapituj. Secili kapitull përmban pjesën narrative dhe tabelën e masave afatshkurtra, e cila përmban masat legislative dhe zbatuese.

Propozimi gjithashtu përcakton qartë përgjegjësitë e institucioneve për zbatimin e këtij programi, si dhe afatet kohore të përmbushjes së këtyre veprimeve dhe burime buxhetore. Programi përmban gjithsej rreth 930 masa, nga të cilat 260 janë masa legislative dhe rreth 607 të tjera janë masa zbatuese. Në anën tjetër, programi gjithashtu përmban prioritetet afatmesme në secilin kapitull. Këto prioritetet japin një orientim të përgjithshëm të zhvillimit të sektorit përkatës përgjatë periudhës 2017-2021, me qëllim zbatimin e Marrëveshjeve për Stabilizim-Asociim dhe kërkesat e tjera që dalin nga procesi i integrimit evropian.

Më lejoni, të nderuar deputetë, gjithashtu t'ju njoftoj se ky program e ka marrë aprovimin edhe në dy komisionet: në Komisionin për Integrim Evropian, si dhe në Komisionin për Implementimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim. Prandaj, do t'ju ftoj edhe juve që ta votoni sot. Programi po ashtu e ka edhe koston totale të zbatimit, e cila është përafërsisht në 484 milionë euro, nga të cilat 398 milionë janë të ndara nga buxheti shtetëror dhe 86 milionë nga mbështetja e donatorëve.

Më lejoni edhe një herë të kërkoj nga ju që ta votoni këtë program. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Ahmetaj! E ftoj përfaqësuesin e Komisionit për Integritet Evropian, zonja kryetare nuk është këtu, është dikush i autorizuar të flasë?

Zonja Bajrami, urdhëroni!

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Integritet Evropian në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2017 e ka shqyrtuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së 2017-2021 dhe ka rekomanduar për miratim në seancën plenare.

Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave afatmesme për periudhën e ardhshme 5-vjeçare 2017-2021, për zbatimin e MSA-së dhe përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, si dhe zbatimin e legjislacionit të përafruar. Të gjitha masat dhe prioritetet janë të ndara në tri blloqe: kritere politike, ekonomike dhe standardet evropiane, përafrim i legjislacionit të Kosovës me atë 'acquis communautaire' të BE-së.

Sa i përket strukturës së programit, ai është ndarë në dy pjesë: pjesën përshkruese tekstuale dhe në pjesën tabelore. Në kuadër të programit për zbatim të MSA-së 2017-2021 parashihet zbatimi i 930 masave, respektivisht i 260 masave legjislative dhe i rreth 670 masave zbatuese, atë që e tha edhe ministrja.

Komisioni për Integritet, në kuadër të fushëveprimtarisë së vet, në baza të rregullta do të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të këtij programi, andaj edhe rekomandojmë që ky program të miratohet si i tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dikush, zoti Haradinaj, s'është këtu. Zoti Nait Hasani, s'është këtu, zoti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ju,

Përschendetje për ministren,

Përschendetje për të nderuarit deputetë të Parlamentit tonë,

Korniza e planifikimit të politikave dhe ajo e ndërveprimit institucional mes dy palëve, pra e Kosovës dhe Bashkimit Evropian, ka avancuar dhe është bërë më dinamike me fokus në zbatimin e reformave që kërkon MSA-ja.

Në këtë kontest të ri, i cili kërkon dinamizmin e reformave dhe përkushtimin politik shumë më të madh në këtë drejtim, zbatimi i MSA-së zhvillohet në kuadër të dy kornizave të planifikimit të politikave; programet për zbatimin e MSA-së dhe agjendës për reforma evropiane. Me fjalë të tjera, Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së është kornizë ombrellë, ndërsa agjenda e reformave evropiane shërben si dokument më i fokusuar që paraqet prioritetet afatmesme dhe masat afatshkurtra për diskutime të vazhdueshme ndërmjet palëve nënshkruese të MSA-së, në nivelin më të lartë politik dhe reformat kyçe që do t'i zbatojë Kosova në procesin e aderimit në BE.

Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave afatmesme për periudhën e ardhshme 5-vjeçare 2017-2021 për zbatimin e MSA-së dhe përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, si dhe zbatimin e legjislacionit të përafruar. Pra, ajo përmban masa afatshkurtra për vitin 2017 dhe prioritete afatmesme, respektivisht masa e prioritetet legjislative dhe masa e prioritetet zbatuese. Bazuar në strukturën e kritereve të Kopenhagës, të gjitha masat dhe prioritetet janë të ndara në tri blloqe: në kritere politike, kritere ekonomike dhe standardet evropiane, gjegjësisht përafrimi i legjislacionit të Kosovës me 'acquis communautaire' të BE-së.

Andaj, edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës propozon që kjo të miratohet në Kuvend sot dhe me këtë do të krijohet një hapësirë e volitshme për zbatimin e masave të Stabilizim-Asociimit, të cilat janë parë me programin për zbatimin e këtyre masave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Vjosa Osmani, Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën, me kartelë tënde?

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi ynë Parlamentar, bazuar në punën që është bërë dhe në analizën e këtij programi në dy komisionet gjegjëse, atë për Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit dhe të Komisionit për Integritet. Ne si grup parlamentar mbështesim një program të tillë për afatin e përcaktuar, gjegjësisht për periudhën 2017-2021, dhe e kemi ditur se kjo marrëveshje që në fillim krijon edhe obligime të caktuara, të cilat pastaj ne si shtet, si institucione, varësisht nga përgjegjësia e secilit prej nesh, do të duhej t'i kryenim ose do t'i kryejmë veçmas për periudhën për të cilën po flasim.

Unë pa hyrë t'i analizoj, sepse u thanë edhe nga parafolësit për ndarjen, formën, kriteret, e të tjera të këtij programi, edhe një herë e konfirmoj mbështetjen e Grupit Parlamentar dhe ne do ta votojmë këtë program për periudhën 2017-2021. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Demaku e ka fjalën.

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, u tha edhe më herët këtu se cilat janë masat që duhet ndërmarrë në bazë të këtij plani. Është e qartë që masat legislative përbëjnë një përqindje tepër të vogël, afro 20% të masave që duhet ndërmarrë në këtë plan kombëtar, ndërsa 70% janë masa zbatuese dhe kritika jonë kryesore mbetet këtu, do të thotë, nga përvoja që kemi pasur nga e kaluara me qeveritë dhe këtë Qeveri, posaçërisht, është se zbatueshmëria është në nivel tepër të ulët dhe kemi tepër pak shpresë që kjo mund të ndryshojë.

Shpresa jonë e vetme dhe mbështetja jonë e vetme mund të vijë, me shpresën do të thotë ta kemi një qeveri në të ardhmen, e cila vërtet përkushtohet në këtë agjendë evropiane, e cila është ndoshta nga pikat e pakta që bashkon opozitën me pozitën, në këtë rast. Kështu që le të shpresojmë që zbatueshmëria të ketë një mbështetje të thellë dhe të madhe nga Qeveria. E di që ministrja nuk e bart barrën kryesore, do të thotë, për zbatimin, sepse është në kuadër të raportimit, e cila mbledh, grumbullon apo shpërndan detyra dhe më pas i merr rezultatet, megjithatë do të thotë opozita kritikën kryesore e ka këtu: te zbatueshmëria e këtij plani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharremaj e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Duke qenë se MSA-ja është nënshkruar nga kjo Qeveri me fusnotë, duke nxjerrë vetëm inicialet e nënshkruesve, pa përmendur Kosovën si shtet, titujt e institucioneve të shtetit apo funksionet.

Ne presim që kështu të bëhet me vetë Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së. Pra, krejt çka është në gjendje të bëjë kjo Qeveri me këtë program është të lërë vetëm inicialet, e asgjë tjetër. Më 10 mars të këtij viti Qeveria e Kosovës ka miratuar Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021, por ky program nuk mund të arrihet me këtë dinamik çfarë e ka sot kjo Qeveri. Ta zëmë, kërkohet sundimi i ligjit, këta vetë janë duke sunduar në emër të ligjit, por sundim të ligjit nuk ka në Kosovë.

Pra, ashtu si MSA për Kosovën, që nuk është qind për qind si ka qenë MSA-ja për shtetet e tjera të rajonit, por është ekuivalente në MSA-në, a do të jetë edhe ky Program Kombëtar ekuivalent me Programin Kombëtar përballë MSA-ve? Kërkohet zhvillim ekonomik, po, këta e kanë

zhvilluar vetveten, por jo Kosovën dhe qytetarët e rëndomtë janë duke jetuar më keq se dje. A dinë të na tregojnë se çfarë programi pretendon të arrijë, cilat janë prioritetet strategjike për këto vite. Gjatë vitit të kaluar kjo qeveri, por edhe ajo paraprakja ka dashur në prioritet që të bëjnë Kosovën të qëndrueshme, zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, eksport, punësim dhe mirëqenie, zhvillimin e shëndetësisë moderne, arsim, sundim të ligjit dhe shtet të së drejtës. Këto janë agjendë evropiane, por fillimisht duket që janë agjenda për vetveten.

S'po përmend këtu politikën e jashtme apo zhvillimin rinor, apo në shkencë dhe kulturë që s'bën, që përveç tjetër, por rastin që iniciativa individuale, të cilat vetëm nëse nuk kanë raste si ato të fundit.

Kosova ka qenë në gjendje të përfitojë nga MSA-ja. A e keni treguar një aftësi të Kosovës për ta arritur prodhimin me këtë dhe me eksportin në BE? A keni përfituar nga kjo marrëveshje edhe në profesionalizimin e administratës dhe përafrimin e standardeve me ato të BE-së në të gjitha fushat, të cilat i përfshin MSA-ja?

Pra, thënë më ndryshe, shumica e atyre pak gjërave që janë arritur janë në shenjë të shpërblimeve për Kosovën për shkak të dialogut, krejtësisht nënshtrues, me Serbinë. Jo pse Qeveria që nga shpallja e pavarësisë ka bërë punë që t'i kemi ato për shpërblim.

Këtë Program Kombëtar që sot po e shqyrtojmë do të mund ta mbështetim vetëm nën idenë dhe angazhimin për të kundërshtuar Qeverinë dhe normalisht pastaj ta ndryshojmë edhe dinamikën e angazhimit në përmbushjen e një programi të tillë për MSA-në e vërtetë për përafrimin me BE-në, jo vetëm participim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën. Më fal, Valdete Bajrami. Me radhë, megjithatë u paraqite vonë Valdete.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues! Kërkoj falje!

Ashtu siç u përmendën vërejtjet edhe nga parafolësit, nuk dua t'i përsëris. Edhe ne i kemi rezervat tona dhe mosbesimin tonë që ky program do të mund të zbatohet ashtu në përpikëri, duke ditur që pikërisht politika drejt Bashkimit Evropian, ose rruga jonë drejt Bashkimit Evropian është në ngecje e sipër dhe kjo falë politikëbërjes së kësaj Qeverie, por edhe qeverive të mëparshme.

Po ashtu, ka vërejtje edhe sa i përket qasjes, e cila i është bërë këtij programi, mirëpo ne shpresojmë, ashtu siç u tha edhe këtu, që së paku të gjejë miratim, ose zbatim, nga Qeveria ky Program Kombëtar për zbatimin e MSA-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Ky Kuvend i Kosovës edhe në legjislaturat paraprake ka miratuar një sërë planesh kombëtare që kanë të bëjnë me procesin e integritimit evropian.

Pa dyshim që ky që ka të bëjë me Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim si marrëveshje e parë kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian e ka një rëndësi më të madhe. Mirëpo, për t'i dhënë vërtet rëndësi do të duhej edhe që puna në zbatimin e masave që dalin nga MSA-ja të jetë e njëjtë. Fatkeqësisht, sipas planit të Qeverisë për 6-mujorin e parë pas nënshkrimit të MSA-së, faktikisht pas hyrjes në fuqi të MSA-së dhe sipas studimeve të Shoqërisë Civile vetëm 27% janë implementuar në atë gjashtëmujor dhe unë shpresoj shumë që dinamika e Qeverisë të jetë rritur në ndërkohë, sepse në qoftë se vazhdohet me ritmin e njëjtë vërtet do të bëhet një kohë tepër e gjatë derisa të implementohet MSA-ja në tërësi.

Unë e kuptoj shumë mirë që për disa prej masave implementimi nuk fillon menjëherë, sepse ka periudhë të caktuar, për shembull, për disa është 3 vjet, për disa 5 vjet dhe për to kemi negociuar vetë që të zgjaten, megjithatë diskutimi lidhur me rëndësinë e implementimit të MSA-së nuk duhet të mbetet vetëm teknik. Duhet ta kuptojmë si Republikë e Kosovës që në momentin kur ne i zbatojmë përgjegjësitë që dalin nga kjo marrëveshje ne mund të aplikojmë për statusin e kandidatit për Bashkimin Evropian.

Natyrisht se do të kemi pengesa politike sa i përket pesësës mosnjohëse në BE, mirëpo ka ardhur koha që si Republikë e Kosovës të fillojmë të flasim për statusin e kandidatit edhe këtu në institucionet e Kosovës, por edhe në dialogun e Brukselit, sepse përderisa Serbia po ecën me një ritëm shumë më të shpejtë, përkundër faktit që vazhdon që të krijojë destabilitet në rajon, Kosova duke e luajtur një rol krejt të kundërt, pra shumë konstruktiv, duke u treguar si faktor i stabilitetit në rajon dhe duke treguar konstruktivitet sa u përket marrëdhënieve me fqinjët, megjithatë nuk po shpërblehet me hapa konkretë sa i përket afrimit me BE-në.

Prandaj, duhet të flasim vazhdimisht për statusin e kandidatit në Bashkimin Evropian, por në të njëjtën kohë të tregojmë seriozitet të njëjtë sa i përket implementimit të masave që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim.

U tha këtu me të drejtë që shumica e obligimeve janë obligime të Ekzekutivit. Vetëm 20% përafërsisht janë masa legjislative që duhet të dalin nga ky Kuvend, mirëpo detyra e Kuvendit nuk është vetëm prodhimi i ligjeve. Detyra e Kuvendit është edhe mbikëqyrja efektive e Qeverisë sa i përket zbatimit të këtyre masave. Prandaj, edhe si komisione, por edhe këtu në seancë plenare, duhet ta rritim mbikëqyrjen në raport me Qeverinë sa u përket masave që dalin nga MSA-ja.

Në fund, unë e inkurajoj Ministrinë e Integritimit Evropian, që të vazhdojë me fushatën vetëdijesuese, sa u përket përfitimeve që mund të kenë qytetarët e Kosovës apo bizneset lidhur me masat që dalin nga MSA-ja, sepse fatkeqësisht është një marrëveshje, e cila akoma mbetet shumë abstrakte për shumicën e qytetarëve të Kosovës dhe nuk e dinë se çka saktësisht nënkupton ajo. Pra, është shumë me rëndësi që edhe ne si Kuvend i Kosovës, por në veçanti Ministria e Integritimit Evropian ta bëjë punën e vet në këtë drejtim, që edhe qytetarët t'i ndiejnë përfitimet drejtpërdrejtë, por edhe ne të ecim me hapa shumë më të shpejtë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje të rëndësishme për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Xhelili, dy herë dëshiron të diskutosh? Ani, zoti Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Unë nuk do ta zgjas, zoti nënkryetar. Faleminderit për fjalën!

Në vazhden e asaj që tha zonja Osmani, unë i kisha propozuar Kuvendit që sot ta miratojë një qëndrim, ose një vendim, që dy herë në vit, së paku çdo gjashtë muaj, të mbahet një raportim për të arriturat e masave, të cilat i zbatojnë institucionet tona dhe të bëhet ai vlerësim, në mënyrë që të jetë vazhdimisht në fokus agjenda evropiane edhe zbatimi i masave të Programit Kombëtar për zbatimin e masave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Kështu që Kuvendi domosdo në këtë mënyrë do të mund ta luante rolin e vet edhe përkundër kësaj, atëherë do të ishte koncentruar edhe komisioni në mbikëqyrjen e disa ligjeve të posaçme, që janë të rëndësishme në disa fusha, posaçërisht në drejtim të zbatimit të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nënkyetar i Kuvendit, zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që sot duhet ta miratojmë patjetër këtë strategji nacionale, edhe pa kualifikime pushtetmbajtëse apo vullnete për pushtet, sepse është për pesë vjet dhe për pesë vjet kurrkush s'e ka të garantuar që është në pushtet, as këta që janë, as ata që vijnë, edhe as ata që eventualisht ndërrohen.

Prandaj, është mirë që bile në këto raste, në projekte nacionale, që janë strategjike, të mos flitet me stërpikje momentale politike.

E dyta, Komisioni për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, që është komision i përbashkët i Kuvendit të Republikës dhe i Parlamentit Evropian, e ka pasur një aktivitet të jashtëzakonshëm brenda dy mbledhjeve. Mbledhjet, siç e dini, mbahen çdo gjashtë muaj, për t'i dëgjuar raportet e ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës dy herë brenda këtij gjashtëmujori, lidhur me sukseset, detyrimet, qoftë legjislative, qoftë zbatuese të programit.

Unë mendoj që ka qenë një bashkëbisedim shumë konkret deri në nivelin e përqindjeve të realizimeve, edhe në legjislacion, edhe në zbatim, dhe të gjitha këto do të marrin kurorë në mbledhjen e përbashkët të komisionit, që do të mbahet pas dy ditësh, në Prishtinë. Atje do të jemi ballë për ballë edhe me pjesën e komisionit që vjen nga Bashkimi Evropian, edhe me Ekzekutivin e Kosovës, që i merr përgjegjësitë për realizimin e programit, edhe me Legjislativin, që është përfaqësimi i Kuvendit tonë në këtë komision.

Pra, desha të them që ka rezultate, ka dhe shënime të sakta të ministrive rreth pengesave, qoftë atyre legjislative, qoftë atyre ekzekutive. Me një fjalë, brenda Kuvendit, institucioneve të Kuvendit, të Qeverisë dhe të Kuvendit, ka një dialog të fuqishëm të diskutimit rreth këtij programi dhe ajo do të shihet, unë besoj, në vepër brenda dy ditësh. Kaq kisha për sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Zonja ministre Ahmetaj, e keni fjalën përfundimtare.

MINISTRJA MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit për diskutimet dhe komentet lidhur me programin, të cilat ne me vëmendje do t'i përcjellim dhe do të mundohemi që në të gjitha komentet që ju i dhatë të përgjigjemi me punë dhe me harmonizim të veprimeve si Qeveri, po ashtu edhe Kuvendi.

Më lejoni vetëm ta bëj një sqarim, që unë si ministre dhe Ministria e Integritimit Evropian në vazhdimësi raportojmë te Komisioni për Integritime Evropiane dhe, po ashtu, edhe te Komisioni për Implementimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim se ku qëndrojmë, si në baza mujore, edhe në raporte periodike, se ku qëndrojmë me implementimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Në raportin detaj të vitit të kaluar që ministria e ka bërë, Marrëveshja për Stabilizim-Asociim nuk është realizuar 27%, sipas të dhënave në gjashtëmujorin e parë të Shoqërisë Civile, por është realizuar mbi 50%. Këto janë shifra, statistika në detaje, që ne i kemi bërë, jo ne si ministri, por në harmonizim dhe bashkëveprim me të gjitha ministrinë e linjës, që kanë për detyrë ta implementojnë Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim.

Sigurisht, me vetë faktin që unë e përmenda që ky program është i buxhetuar deri në detaje tregon që ne e kemi planifikuar me saktësi edhe realizimin dhe implementimin e tij. Sigurisht, ju jeni Kuvendi që do të na mbani në vazhdimësi përgjegjës për realizimin e objektivave, që janë tonat si Qeveri, por edhe të Kuvendit dhe të Kosovës si shtet. Ju falënderoj edhe një herë për kontributin!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Sa i përket votimit, ne po vazhdojmë me diskutime, për shkak se deputetët nuk janë aq sa duhet... Atëherë, regjia, ju lutem t'i bini ziles! Ka qenë mirë të jenë në sallë, katër-pesë pika para pauze e përfundojmë dhe...

(Ndërprerje e incizimit)

Faleminderit! Në sallë i kemi 67 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim, për ta votuar shqyrtimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017 - 2021. Votojmë tash!

E përsëritim edhe një herë, ju lus, për shkak të pengesave teknike në sistem. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Unë mendoj se pavarësisht atyre që duan ta sabotojnë votimin, programi do të vazhdojë të realizohet, kështu që kujt i mbushet mendja për të votuar, voton. Ju që doni të sabotoni gjithçka, sabotoni, vazhdoni derisa të mundni. Faleminderit!

12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me propozimin e vendimit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për mosmiratim.

Unë dua të ndalem këtu: Nuk ka parlament në botë që e shqyrton propozimin e komisionit, ose që e fut në shqyrtim propozimin e komisionit, pa kaluar në komision. Ne s'e kemi kështu, por po e shqyrtojmë, po e dëgjojmë dhe realisht, në përputhje me ligjin, nuk është dashur të vijë kjo në shqyrtim në Parlament fare, për faktin se nuk është numri i caktuar i atyre të propozuarve nga komuniteti serb, ose nga Lista serbe, qysh bëhet propozimi për numrin e caktuar të zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Sidoqoftë, unë ia jap fjalën, sipas rregullave, kryetares së Komisionit Funkcional, zonjës Lirije Kajtazi, që të paraqesë dhe arsyetojë rekomandimin për mosmiratimin e propozim-vendimit të Avokatit të Popullit.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2017, bazuar në nenin 10 të Ligjit për Avokatin e Popullit, neni 7 i Rregullores për procedurën e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe të

zëvendësve të tij dhe nenin 62 të Rregullores së Kuvendit e shqyrtoi propozim-vendimin nr. 20/2017 të datës 20 mars 2017 të Institucionit të Avokatit të Popullit për kandidatët e propozuar për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit dhe vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m:

1. Propozim-vendimi nr. 20/2017, datë 10 mars 2017, i Avokatit të Popullit për kandidatët e propozuar për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit t'i kthehet Institucionit të Avokatit të Popullit.

2. Propozimi për kandidatët për zëvendës të bëhet në përputhje me nenin 10, paragrafi 3 i Ligjit nr. 05/L-090 për Avokatin e Popullit dhe në përputhje me nenin 8, paragrafi 3 i Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij.

A r s y e t i m:

Institucioni i Avokatit të Popullit i ka propozuar kandidatët për zgjedhjen e pesë zëvendësve dhe sipas propozim-vendimit nr. 20/201, datë 10 mars 2017, nuk është plotësuar kriteri i propozimit të së paku dy kandidatëve nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ky propozim-vendim duhet të jetë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe gjithashtu me nenin 8, paragrafi 3 i Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit, ku thuhet për një pozitë, zëvendës të Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve joshumicë dhe për një pozitë zëvendës i Avokatit të Popullit nga radhët e gjinisë tjetër nga ajo e Avokatit të Popullit, votimi bëhet i ndarë sipas propozimit të Avokatit të Popullit.

Pra, rekomandimi është që t'i kthehet Avokatit, në mënyrë që të plotësohet ky kusht ligjor.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Musliu e ka kërkuar fjalën, në emër të... Ku është zonja Musliu? S'është. Në rregull! Zoti Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Unë e mora fjalën në emrin tim personal, por edhe të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje" për të thënë që ky rekomandim i komisionit është shkelje flagrante e pavarësisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, ngase Avokati i Popullit ka propozuar dhjetë emra. Brenda atyre dhjetë emrave për zëvendës-avokat është një person që është i komuniteteve joshumicë dhe katër të gjinisë femërore.

Me këtë faktikisht Avokati i Popullit e ka respektuar edhe Kushtetutën, edhe ligjin, por në ligj përcaktohet që Avokati i Popullit për zgjedhjen e një zëvendësi propozon së paku dy kandidatë.

Domethënë, këtu nuk thotë çfarë kandidatësh dhe për pesë zëvendës- avokatë të popullit, ai ka propozuar dhjetë kandidatë, që Kuvendi ta zgjedhë. Pastaj, në aspektin e procedurës, në procedurë nuk përcaktohet nëse duhet të jenë lista të ndara apo kështu, por në aspektin e procedurës thotë që gjatë procedurës së zgjedhjes së kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit duhet të sigurohet përfaqësimi etnik dhe gjinor. Të paktën njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit duhet të jetë pjesëtar i njërit nga komunitetet dhe gjinisë tjetër, e cila ndryshon nga ajo e Avokatit të Popullit.

Në këtë aspekt, domethënë Kuvendi ka mundur ta nxjerr listën ashtu siç është dhe të kërkojë që të votohet kandidati jominorit, po ose jo, edhe kandidatët tjerë, të cilët kanë qenë në aspektin e listës, ashtu siç është propozuar.

Tani me kthimin mbrapa të listës së kandidatëve për Avokat të Popullit, faktikisht ky Kuvend do ta shkelë Kapitullin 12 të Kushtetutës për institucionet e pavarura, ngase Kuvendi po thotë që ju nuk mund t'i zgjidhni zëvendësit e juaj, por duhet të bëni sipas kërkesave të komisionit, ngase si për shembull, neni 132, pika 2 thotë që Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet.

Në momentin që ne do të kërkojmë Avokatit të Popullit që ta ndajë listën dhe në listë të ketë një kandidat, i cili, si për shembull, nga komunitetet joshumicë, e cila është e dyta në listë së bashku me kandidatin tjetër, i cili është 35-ti në listë, atëherë në momentin që ky institucion e zgjedh kandidatin e 35-të në listë, kjo do të jetë edhe shkelje e kualitetit të zëvendës-avokatëve të popullit, por edhe shkelje e të së drejtës së Avokatit të Popullit për punën e tij të pavarur.

Pastaj, neni 133, pika 1 thotë që Avokati i Popullit është i pavarur. Pika 2 thotë që Avokati i Popullit ka një ose më shumë zëvendës, numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre rregullohet me ligj. Të paktën një zëvendës i Avokatit të Popullit duhet të jetë pjesëtar i komuniteteve joshumicë. Domethënë, në të gjitha këto pika Avokati i Popullit faktikisht i ka respektuar dhe na ka dhënë edhe një kandidat, i cili është joshumicë.

Në fund po them që Avokati i Popullit e ka plotësuar edhe kushtin ligjor, ngase ai i ka dërguar dhjetë kandidatë për pesë pozita të zëvendës-avokatëve dhe çka është dashur të bëjë komisioni, është që ta procedojë listën dhe ndoshta lista të ndahet për ta votuar anëtarin e komunitetit joshumicë dhe pjesën tjetër. Por, unë këtu edhe një herë desha ta theksoj edhe këtë, në momentin që ne për shkak të Rregullores shkojmë në kundërshtim me ligjin dhe me Kushtetutën, se tash për shkak të një pike të Rregullores po shkojmë në kundërshtim me ligjin, por në kundërshtim edhe me Kushtetutën e Kosovës. Pra, po e shkelim parimin e pavarësisë së Avokatit të Popullit për shkak të një pike, e cila faktikisht nuk është e specifikuar edhe ashtu qartë. Këtu, për shembull, kërkohet që njëra nga pozitat të jetë e gjinisë së kundërt nga Avokati i Popullit.

Ne në listë i kemi katër persona të gjinisë femërore. Çka nëse Kuvendi do të kishte zgjedhur katër gra, e jo bura. Me ndarjen e listës në baza gjinore, ne faktikisht po e shkelim të drejtën e kandidatëve të tjera të zgjidhen si zëvendëse të Avokatit të Popullit.

Në momentin që e ndajmë listën për meshkuj dhe për femra, atëherë me një farë aspekti po ua pamundësojmë kandidatëve gra, të cilat janë në listë të zgjidhen si zëvendëse të Avokatit të Popullit, edhe me një farë aspekti duke u bazuar në një rregullore të procedurës zgjedhore të zëvendësve të Avokatit, ne faktikisht po i shkelim të drejtat bazike të qytetarëve të Kosovës, duke i diskriminuar, edhe pse po paraqesin si diskriminim pozitiv. Faktikisht është diskriminim negativ, ngase po pamundësojmë të zgjidhen më shumë gra zëvendëse të Avokatit apo më shumë persona të minoriteteve si zëvendës të Avokatit.

Këtë e themi vetëm si, një duhet të zgjidhet ose vetëm këtë.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto, unë besoj që është dashur ne ta votojmë listën ashtu si është dërguar nga Avokati i Popullit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë nuk po dua të të sqaroj, komisioni le ta bëjë. Zonja Mustafa e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka analizuar rekomandimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me propozim-vendimin e institucionit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve të tij.

Mbështesim rekomandimin e komisionit që ky propozim-vendim t'i kthehet Avokatit të Popullit, sepse sipas Ligjit për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Rregullores së Kuvendit për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij nuk plotësohen kushtet me këtë propozim-vendim, për arsye se institucioni i Avokatit të Popullit ka propozuar kandidatët për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe sipas propozim-vendimit 20/201, datë 10 mars 2017, nuk është plotësuar kriteri i propozimit të së paku dy kandidatëve nga komuniteti që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ne si grup parlamentar kërkojmë që zgjedhja e zëvendësve të Avokatit të Popullit, edhe pse është e vonuar, të bëhet në harmoni me ligjin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit për zgjedhjen dhe shkarkimin e zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Prandaj, kërkojmë që kjo të shtyhet, të plotësohet me komunitetin joshumicë dhe të na sillet neve në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Atëherë po e arsyetoj votën time kundër në komision. Vërtet institucioni i Avokatit të Popullit, si kategori kushtetuese dhe si institucion i pavarur, me një detyrë dhe shumë rekomandime, të cilat prej vitit në vit kanë shënuar rritje deri në 200 për qind dhe duke e ditur që, mbi të gjitha, institucioni është për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ne nuk mendoj që jemi më ekspertë se sa vetë Avokati me stafin dhe nga arsyeshmëria që e kemi pasur me orë të tëra, të mos them në komision vetë Avokatin për sqarimet e tij, unë mendoj që Avokati nuk ka bërë shkelje dhe të mos harrojmë se rregulloret janë akte nënligjore, kurse ligji është që rregulloret derivojnë nga vetë ligji.

Prandaj, në bazë të ligjit Avokati ka vepruar drejt, ai i ka përmbushur të gjitha faktet duke sjellë 10 kandidatë në mesin e tyre, pra nga të dy gjinitë, po edhe nga komuniteti dhe nëse duam që vërtet brenda institucionit të Avokatit të Popullit të ketë njerëz me vlera, duke i përmbushur të gjitha kriteret, pa lënë anash as komunitetet, sepse edhe renditja e kandidatës nga komunitet, siç e ka treguar Avokati, pra e dyta apo e treta në listë, tregon që vërtet duhet të punohet në vlera dhe jo të shkohet sipas renditjes diku kah fundi i listës, sepse vetë Komisioni i përzgjedhjes, siç na ka treguar Avokati, ka qenë i përbërë edhe nga tre përfaqësues të jashtëm dhe krejtësisht të pavarur.

Prandaj, mendoj që veprimi i Avokatit të Popullit dhe kërkesa e tij që t'i dërgohet Kuvendit lista prej 10 kandidatëve dhe Kuvendi do të duhej të procedonte me votimin e kandidatëve për t'i zgjedhur pesë zëvendës, në mesin e tyre thashë duke plotësuar edhe kriteret që u përmendën pak më herët edhe kriterin që të ketë nga gjinia e kundërt, pra nga gjinia femërore, por edhe kriterin që një nga pesë zëvendës të jetë nga komunitetet e tjera joshumicë.

Prandaj, të gjitha këto janë përmbushur në listë, janë përmbushur në listën që e ka sjellë Avokati dhe unë mendoj që deputetët nuk janë më profesionistë, nuk janë më juristë se sa vetë Avokati.

Prandaj, kërkoj që lista të procedohet ashtu siç e ka sjellë Avokati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Ndoshta më mirë që u prish rendi për t'iu përgjigjur edhe pjesës tjetër. Së pari flas në emër të LDK-së, e cila e përkrah rekomandimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, për arsye se bazohet në ligj.

Ndërsa për të shtuar edhe çështjen tjetër të mjegullës që shkaktuan edhe "Vetëvendosje" edhe Aleanca, unë prapë e rilexoj ligjin dhe dua të them se Avokati i Popullit për zgjedhjen e një

zëvendësi i propozon Kuvendit së paku dy, do të thotë për zgjedhjen e një zëvendësi që duhet të jetë nga komuniteti joshumicë, duhen së paku dy. Kjo mendoj është shumë e qartë, ndërsa Rregullorja flet edhe për më shumë, për ata që nuk e kuptojnë qartë ligjin, ndërsa a jemi përzier a nuk jemi përzier në një institucion të pavarur, i cili nga Kushtetuta është i pavarur, por do të thotë nga përzierjet tona, ndërsa nga ligji e nga Kushtetua askush nuk është i pavarur, duhet të japë llogari dhe në këtë aspekt ne e kërkojmë respektimin ligjor, të cilin duhet ta bëjë ky institucion, pavarësisht a është jurist apo çfarë, ligji është mbi të gjithë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën, nuk ka replikë, qëndrimin e LDK-së e ka. Mirë de, jemi një herë në emër të grupeve, tani mund ta marrësh. Nëse do, bëj replikë, po kjo nuk bëri replikë, mirë, vazhdo!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit!

Prandaj, pikërisht për shkak që të mos krijohet amulli edhe te deputetët e tjerë, sepse mbi të gjitha neve si anëtarë të komisionit na bie barra kryesore, por kriteret janë përmbushur dhe së paku dy, dhjetë janë, e nderuar, dhjetë, pesë do të zgjidhen, të gjitha kriteret janë përmbushur. Edhe një herë, Avokati është institucioni që ne më së paku do të duhej të pretendonim të ndërhyjmë. Prandaj, mendoj se të gjitha kriteret janë përmbushur dhe do të duhej të silllej lista këtu.

Kemi kërkuar interpretim ligjor nga Zyra Ligjore në Kuvend, nuk na e ka sjellë. Ka ardhur drejtori në komision dhe, thjesht, asnjë arsyeshmëri dhe nuk kanë qenë të gatshëm të na e sjellin një interpretim ligjor.

Prandaj, edhe një herë, 10 kandidatë kanë ardhur dhe do të duhej ne të procedonim me zgjedhjen e pesë zëvendësve dhe pikërisht kjo është ndërhyrje në këtë institucion nëse vërtet ne pretendojmë ta kthejmë këtë listë.

Prandaj, lista e propozuar prej Avokatit do të duhej të ishte këtu, të gjithë kandidatët janë, pra do të kemi mundësi për t'i zgjedhur të gjitha kategoritë, pra qoftë nga gjinia mashkullore, femërore, po edhe komunitetet joshumicë dhe atë me një cilësi, duke mos ndërhyrë brenda institucionit vetë, në të kundërtën, ne bëjmë ndërhyrje brenda këtij institucioni.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Unë para se të lidhem për pikën që jemi duke biseduar, për shqyrtimin e rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, shpreh shqetësimin tim që mbledhjet e komisioneve po mbahen gjatë seancave plenare, kështu që ne po detyrohemi në njëfarë forme të shkojmë herë në komision e herë në seancë, e realisht duhet të koordinohet Kryesia e Kuvendit me kryetarët e komisioneve dhe në rastin kur ka seanca, të shtyhen mbledhjet e komisioneve, por

edhe seanca plenare të respektojë afatet dhe ditët që i kanë obliguese, e jo të mos mbajë nga dy muaj seancë, e pasi grumbullohen, domethënë ndërhyjnë edhe në komisione.

Sa i përket shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me propozimin e Vendimit nr. 20/2017 të datës 10 mars të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve.

Ne mendojmë se Avokati i Popullit ka pasur shumë problematika lidhur me zgjedhjen e zëvendësve. Në të kaluarën këta kanë pasur problem edhe me buxhetin.

Ne mendojmë se Avokati i Popullit i ka plotësuar të gjitha kriteret edhe i ka ndjekur të gjitha procedurat për zgjedhjen e zëvendësve të tij.

Prandaj, mendojmë që është shumë e arsyeshme që ajo listë të silltet në Kuvend dhe të votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rashiq e ka fjalën.

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Zahvaljujem se i kolegama, koji su takođe iz komisije dali svoj doprinos, ali čini mi se da jedan broj kolega zaboravlja suštinu onu koju smo i tad na komisiju i sa veličinom glasova izglasali, a to je bilo a je Narodni advokat prekršio proceduru ili je prekršio pravila i to naglašavam. Više puta sam rekao na komisiji i ponavljam i sad.

U pravilniku koji takođe je urađen da bi olakšao sprovođenje zakona o Narodnom advokatu kaže da se za jednog iz nealbanske zajednice Narodnog advokata glasa posebno, i na tom listiću ima dva kandidata, opet ponavljam, glasa posebno. Jer, to je bila jedna od stvari koje sam naglašavao od samog početka i bez obzira koji je na listi drugi potencijalni kandidat, to nije na Narodnom advokatu da odluči. On mora da ispoštuje proceduru i da da dva potencijalna kandidata, za koje bi mi glasali ovde.

To je apsolutna suština svega o čega svi mi ovde, sada kažem, i sporimo, iako sam sa kolegama pričao i na komisiji, mislim da to treba da bude najjasnije.

Drugo, što mislim da treba znati, ovo nije problematika od juče. Po sećanju znam pre nekih šest meseci, a moje kolege iz komisije to znaju, da je Narodni advokat takođe predložio produženje mandata onim pređašnjim, odnosno aktuelnim zamenicima Ombudspersona, gde je ili kojima je već tri godine istekao mandat. Što znači u prvoj nameri produženje mandata tim postojećim ili aktuelnim zamenicima Narodnog advokata je po meni sa jednom tendencijom prekršena procedura, jer je to bilo na osnovu starog zakona, a novi zakon je već bio na snazi. I sad u ovom

drugom pokušaju, gde se daje samo jedan kandidat iz nealbanske zajednice, i daje se to u paketu, bez posebnog glasanja. Meni je žao što moram ovo da kažem, ali čini mi se da postoji neka tendencija od strane Narodnog advokata da se procedura na neki način malo zaobiđe.

I opet kažem oni jesu, odnosno Narodni advokat jeste autonomni i da ga nazovem nezavisni organ, ali nijedan organ, bilo da je zavisni ili nezavisni, ne sme da krši zakonske procedure.

U tome je ovde suština. Mi vraćamo, odnosno predlažemo na vraćanje, na ponovno konkurisanje baš iz tog razloga, zato što nije taj isti zakon, ta ista procedura, koju bi Narodni advokat trebao najviše da vodi računa o tome, da je ne prekrši, u ovom slučaju je prekršena. Sad mi možemo da imamo političke simpatije ili antipatije, ali dokazi ili činjenice kažu da je prekršena procedura, i nije to usmereno na ličnoj osnovi pred protiv bilo koga, samo je naravno usmereno u zaštiti istog tog zakona i te iste procedure. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Qerim Bajrami, e ka fjalën, pastaj zonja Emilija.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem, predsedavajući!

I mi iz Parlamentarne grupe "6+" smatramo da je procedura predloga kandidata iz nevećinske zajednice za zamenika Narodnog advokata prekršena i smatramo da je u redu da se još jednom čitava procedura dakle preispita, odnosno da se vrati Advokatu na ponovno ispitivanje i da se izbor kandidata iz nevećinskih zajednica razmotri malo bolje, jer da podsetim da Bošnjačka zajednica svih ovih godina, bez obzira što je treća po brojnosti na Kosovu, nije imala svoga predstavnika u ovu kancelariju Narodnog advokata, što je verovatno uticalo i na neredovno praćenje kršenja ljudskih prava među Bošnjacima i drugim zajednicama na Kosovu.

Dakle, smatramo da se ovo pitanje treba malo bolje razmotriti i među petoro zamenika treba najmanje da se nađe i jedan Bošnjak, bez obzira što ovo deluje subjektivno, ali konačno je red da Bošnjaci dobiju svoga predstavnika u toj kancelariji. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi.

EMILIJIA REDŽEPI: Zahvaljujem se, predsedavajući!

I ja sam takođe htela da govorim o načinu i radu, odnosno ovom izveštaju Komisije za ljudska prava, ravnopravnost polova, nestalih lica i peticija o današnjem izveštaju po pitanju Narodnog advokata, i želim javno da sugerišem nekim poslanicima ovde, koji smatraju da kandidati koji dolaze iz redova nevećinskih zajednica budu tretirani po vrednosti i intelektualnih sposobnosti na nekoj skali, drugom, petom ili desetom mestu, i na osnovu čega to pojedini poslanici tako smatraju i ocenjuju njihovu intelektualnu sposobnost.

Kao drugo, želim da takođe uputim apel narodnim poslanicima da kada selektiraju, odnosno komisiji, odnosno članovima koji su unutar te komisije, kada selektiraju kandidate obavezno, obavezno znači podvlačim, prate implementaciju zakona, odnosno o zaposlenosti manjinskih zajednicama u javnim institucijama.

Ako govorimo sada danas o komisiji koja je donela na predlog da budu pet zamenika, smatram da uvek treba da se sugeriše komisiji, da kada su u pitanju nevećinske zajednice, vrši selekciju, odnosno obavezno srpsku zajednicu stavlja na jednu stranu a ostale zajednice, odnosno kandidate koji se žele kandidovati i takmičiti za mesto zamenika Narodnog advokata iz drugih zajednica, tako da ćemo imati dva zamenika ispred nevećinske zajednice.

To je naše zakonsko pravo, koje nam Ustav Republike Kosova dozvoljava. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për të gjithë,

Unë konsideroj që institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë propozimin e kandidatëve në mënyrë të drejtë, mendoj që duhet të vazhdohet me procedurë që të zgjidhen katër zëvendës të Avokatit të Popullit. Kurse për kandidatin e komunitetit joshumicë të përsëritet procedura.

Nëse marrim nenin 10, ku i ka 9 paragrafë, paragrafi 3 ku thirret komisioni, këtë paragraf e ka plotësuar, do të thotë për katër vende Avokati i Popullit, kurse paragrafi 5 nuk plotësohet. Edhe te paragrafi 5 citohet që thotë se duhet të jetë njëri nga komunitetet joshumicë, nuk e cakton a do të jetë i komunitetit serb apo i komuniteteve të tjera.

Unë mendoj që nuk shkelet procedura nëse vazhdojmë me zgjedhjen e katër zëvendësve të Avokatit të Popullit, kurse procedura përsëritet vetëm për një zëvendës, them te zëvendësi joshumicë.

Të kundërtën, ne bëjmë shkelje të procedurave nëse ka qenë një konkurs i hapur, transparent, ku është respektuar ligji, janë respektuar të gjithë paragrafët, përveç te paragrafi 5, mendoj që nuk duhet të përsëritet konkursi për katër zëvendës, vetëm për një zëvendës joshumicë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po tash nga dy herë, u krye diskutimi, gjithçka po dihet, ne mund të flasim gjithë ditën për të njëjtën çështje, rregullat janë rregulla, qëndrimet janë qëndrime, edhe ashtu kuorum nuk kemi, por edhe unë po besoj që duhet të kthehet ashtu siç ka ardhur dhe t'i plotësojë kushtet me dy kandidatë nga pakica, siç po kërkohet dhe qysh e kërkon ligji, edhe ne e votojmë pastaj në seancë plenare.

13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me zbatimin e Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ne është mirë ta bëjmë si rregull që të bëjmë pauza në mes të seancës, të pihet kafë dhe të kthehemi në sallë, se kështu qysh po krijohet kaos pas kafesë, është problem.

Meqenëse u bë kuorumi, po e fus pikën:

12. Votimi i shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me propozimin e vendimit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit

Ne i dëgjuam diskutimet, i dëgjuam edhe konkluzionet e Komisionit Funkcional. Atëherë në përputhje me vullnetin tuaj, po besoj me ligjin dhe me Kushtetutën dhe sipas Rregullores së Kuvendit, vota është juaja, votojmë tash:

Kanë votuar 63 deputetë, 44 janë për propozimin e komisionit, 11 kundër dhe 8 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur për Peticione lidhur me propozimin e vendimit të Avokatit të Popullit për zgjedhjen e pesë zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Pa dashur ta ngacmoj askënd, as ta këshilloj, sepse po them, vota është juaja, por ne e kemi plot gojë Evropë dhe ne sot nuk e votuam... Jo kuorum patëm, por nuk e votuan. Dua t'ju them që pasnesër Komisioni i Stabilizim-Asociimit e ka takimin e radhës, takimin e tretë dhe nuk do të ishte mirë të na gjente pa e miratuar. Shpresoj që nesër kryetarët e grupeve parlamentare do të bisedojnë edhe me deputetët që ta votojmë, ose sot. Është mirë sot, nëse ka mirëkuptim, por në qoftë se vjen nesër Komisioni i Stabilizim-Asociimit i Parlamentit Evropian dhe ne nuk e kemi të votuar, është problem për Parlamentin, nuk është problem për asnjë parti.

Atëherë po e nxjerrim edhe një herë në votim, këqyrni a është dikush në korridor, pra ta kalojmë.

Të nderuar kolegë, e hedh edhe një herë në votim për vëmendjen tuaj:

11. Votimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021

Votojmë tash! Faleminderit!

Kanë votuar 64 deputetë. 64 vota janë për.

Unë po besoj që e bëmë një punë jashtëzakonisht të mirë dhe një sinjal shumë të mirë për Kuvendin e Kosovës, edhe për Brukselin. Faleminderit prej të gjithëve!

Atëherë, konstatoj që Kuvendi e miratoi Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për periudhën 2017-2021.

13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me zbatimin e Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, zotin Haxhi Shala, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Shala, e keni fjalën.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë në mbështetje të nenit 71, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, ka realizuar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.

Qëllimi i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit ishte që komisioni të vlerësojë nivelin e zbatueshmërisë në praktikën e këtij ligji. Gjithashtu, komisioni kishte për qëllim të vlerësojë nëse AKI-ja, konkretisht Departamenti i Verifikimit, është duke i përmbushur detyrimet e tij ligjore, përmbledhjen e informacioneve për vlerësimin lidhur me zbatimin e ligjit dhe standardeve të përcaktuara.

U shfrytëzuan këto burime: vizita pune në terren dhe intervista me përfaqësuesit e shumë institucioneve, aktivitetet mbikëqyrëse, ku u ndërmorën në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Gjykatën Themelore në Prishtinë, Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, ambasadat e Kosovës në Bruksel dhe atë në Tiranë dhe ka realizuar një vizitë studimore në

Republikën e Shqipërisë. Në përfundim të procesit ka arritur të identifikojë të gjeturat kryesore rreth zbatimit të Ligjit nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë me sa vijon:

- Ligji në masë të madhe nuk zbatohet nga institucionet publike e shtetërore të Republikës së Kosovës. Shumica e institucioneve nuk kanë lista të informacioneve të klasifikuara sipas niveleve dhe klasifikimit që parasheh ligji, nuk i kanë hapësirat e nevojshme të ruajtjes së këtyre informacioneve, nuk kanë libra, regjistrat e evidentimit të shpërndarjes së këtyre informatave, duke bërë që këto informata të mbesin të shpërndara dhe, rrjedhimisht, edhe të padobishme. Procesi i verifikimit të sigurisë është përcjellë me shumë sfida, ka pasur paqartësi rreth procedurave dhe dyshimeve për joobjektivitet në raste të caktuara, sepse vendimet për dështim të verifikimit janë marrë mbi bazat e fakteve jorelevante.

Pezullimi i punës së Departamentit të Verifikimit dhe shpërndarja e personelit të tij në njësi të tjera organizative paraqet shkelje të ligjit, sepse ky departament është institucioni themelor, i themeluar me ligj dhe vendim, pezullimi i tij nuk ka mundur të bëhet pa ndryshuar paraprakisht bazën ligjore për këtë. Gjyqtarët që i kanë trajtuar rastet e ankimimit të individëve që kanë dështuar në verifikimin nuk kanë leje të sigurisë dhe kjo paraqet një defekt në kuadër të këtij procesi.

Zyrtarët që punojnë përkthyes në këtë nuk kanë leje të sigurisë dhe kjo duhet të korrigohet në të ardhmen, niveli jo i duhur i bashkëpunimit në mes të njësive organizative të ministrave, agjencive, departamenteve sa i përket zbatimit të ligjit, Kuvendi nuk ka salla, hapësira dhe kuadro, të cilat i plotësojnë kriteret e sigurisë dhe zhvillimit të takimeve në këto komisione. Ministria e Forcës së Sigurisë dhe Banka Qendrore janë institucione, të cilat zbatimin e këtij ligji e kanë bërë në mënyrën më të avancuar, krahasuar me institucionet e tjera. Shumica e personelit që punojnë në ambasada nuk kanë leje të sigurisë.

Banka Qendrore në mënyrë të pavarur, mbështetur në legjislacionin përkatës të saj, në Ligjin për BQK-në dhe Rregulloren e brendshme të fshehtësisë, zbaton sistemin e saj të klasifikimit të informatave dhe qasjen në to. Ajo, po ashtu, nuk e ka të miratuar edhe listën e informatave të klasifikuara. Duke u mbështetur në këto të gjetura, komisioni paraqet rekomandimet për miratim në seancë, në mbledhjen e mbajtur më 5.04.2017, i cili komision i ka miratuar këto:

R e k o m a n d i m e

- Ligji duhet të zbatohet në plotësi nga të gjitha institucionet, derisa është në fuqi dhe nuk mund të ketë suspendim të zbatimit të dispozitave të caktuara nga asnjë institucion apo titullar të institucioneve;

- Departamenti i Verifikimit të Sigurisë duhet të pavarësohet nga Agjencia Kosovare për Inteligjencë dhe të krijohet një institucion përkatës i pavarur për kryerjen e procedurave të verifikimit;
- Qeveria e Kosovës të procedojë për miratim në Kuvend projektligjin, me të cilin do të themelohet ky institucion;
- Institucionet përkatëse duhet të hartojnë listën e dokumenteve të klasifikuara dhe të krijojnë kushte për ruajtjen e këtyre informatave në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Institucionet përkatëse duhet të pajisen me hapësira, salla adekuate, të cilat i plotësojnë kriteret për të zhvilluar takime, ku diskutohen çështjet apo informatat e klasifikuara;
- Kuvendi i Kosovës duhet të ndërtojë një sallë të takimeve, e cila i plotëson kriteret e sigurisë, në të cilën duhet të mbahen takimet e Komisionit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe Sigurisë;
- Ministria e Punëve të Jashtme duhet të marrë veprimet e nevojshme që personeli i ambasadave t'i kalojë procedurat e verifikimit dhe të pajiset me certifikata të sigurisë dhe duhet të krijojë hapësirat e nevojshme ku ruhen informatat e klasifikuara;
- Të ngrihet niveli i bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitutional mes institucioneve zbatuese të këtij ligji dhe Departamenti për Verifikimin e sigurisë nëpërmjet aktiviteteve dhe masave që lehtësojnë procesin, siç janë: tryezat, udhëzimet, manualët;
- Gjyqtarët që i trajtojnë lëndët lidhur me ankesat rreth procesit të verifikimit duhen të jenë të pajisur me certifikatën e sigurisë;
- Subjektet juridike që ofrojnë shërbime në furnizim, mirëmbajtje të faqeve zyrtare, rrjetet e internetit, shërbimeve të përkthimeve duhen të jenë të pajisura me certifikatën e sigurisë;
- Institucionet përkatëse duhet të marrin masa që nëpunësit civilë që punojnë në pozitë e përkthyesve gjuhësorë, të cilët gjatë punës së tyre mund të kenë qasje në informatat e klasifikuara, të pajisen me certifikatat e sigurisë.

Faleminderit! Kërkoj që ky raport të votohet nga deputetët.

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, respektivisht e kryetarëve. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Agim Çeku e ka fjalën.

AGIM ÇEKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë me rekomandime dhe i jep mbështetje të plotë këtij raportit dhe të gjitha rekomandimeve që sapo i dëgjuam këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Milazim Haliti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e ka fjalën.

MILAZIM HALITI: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë dhe vlerëson se komisioni ka bërë një punë të mirë, duke ndërmarrë aktivitete mbikëqyrëse në Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, pastaj në Ministrinë e Drejtësisë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Forcës së Sigurisë, në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe në Ambasadën e Kosovës në Shqipëri dhe Bruksel dhe, në përgjithësi, i përkrah rekomandimet dhe raportin në fjalë.

Andaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së kërkoj që deputetët e Kuvendit të miratojnë raportin me 11 rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zonja Dërguti e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar me kujdes raportin me rekomandimin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë dhe pas këtij shqyrtimi ka vendosur që ta përkrahë raportin së bashku me rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën, në emër të AAK-së.

RRUSTEM BERISHA: Edhe Grupi Parlamentar i AAK-së e ka shqyrtuar raportin me rekomandime dhe pas shqyrtimit, ne do ta përkrahim këtë raport dhe këto rekomandime që i dëgjuam edhe prej kryetarit të komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shala, a do të flasësh prapë? Zoti Shala, në emër të “Nismës”, e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Edhe ne si Grup Parlamentar do t'i japim mbështetje dhe do ta votojmë këtë raport të nxjerrë nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, vetëm kërkojmë nga Qeveria dhe të gjitha institucionet që në bazë të këtij raporti të gjejnë zbatueshmëri ose të zbatojë Ligjin e verifikimit dhe të sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të “6+” zonja Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Hvala!

Parlamentarna grupa "6+" se vršila razmatranja svih 11. preporuka vezanih za Zakona, sprovođenje Zakona o klasifikacije, informacije, verifikacije bezbednosti, i saglasna je sa svih 11. preporuka i podržava raport sa preporukama. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryesues Haliti!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë vetën mund të përkrah dhe të lëvdoj Komisionin për Mbikëqyrje të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë që ka bërë një punë të mirë dhe me gjetjet dhe rekomandimet e qëlluara, ku ka treguar edhe performansën e vet në saje të 11 rekomandimeve. Pra, unë qysh para shtatë vjetëve, kur është bërë ky ligj, kam pasur vërejtje, për arsye se ky ligj duhet të jetë i përbërë nga dy dhe jo nga një ligj, pra i ndarë në Ligjin për klasifikimin e informacioneve, verifikimin e sigurisë, por atëherë s'më dëgjuan shumë dhe tash kemi ardhur në një situatë mjaft delikate, kur me vendim të Qeverisë është bërë edhe pezullimi i punës së Departamentit për Verifikimin e Sigurisë, çka është e paakceptueshme, për arsye se është shkelje edhe e ligjit. Por, sido që të jetë, kjo është edhe e gjetur dhe ato kuadro janë shpërndarë në departamentet e tjera.

Gabimi u bë që në fillim atëherë, kur Departamenti për Verifikimin e Sigurisë është vendosur në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë nga arsyeja se është shkelur parimi kryesor i aspektit që Agjencia Kosovare e Inteligjencës nuk ka autorizime ekzekutive. Me këtë ajo ka marrë një autorizim të paqenë, pra kur në kuadër të kësaj është futur Departamenti për Verifikimin e Sigurisë, për arsye se ata kur t'i bëjnë verifikimet, atëherë marrin autorizime për verifikime nga burime të ndryshme edhe të dalin me konstatime.

Gjithashtu, ligji, pra, nuk e di njëra prej gjetjeve është dashur edhe të fokusohet që ky ligj të bëhet, edhe pse kjo procedurë është, por të bëhen dy ligje, apo të derivohen dy ligje nga ligji ekzistues. Edhe Departamenti për Verifikimin e Sigurisë mendoj që do të mendohet në të ardhmen me ligjin e ri që të futet edhe si organ edhe i zgjedhur, por edhe që i jep përgjegjësi Kuvendit të Kosovës dhe të mos jetë në kuadër të ekzekutivit apo eventualisht të ndonjë resori ministror apo ndonjë departamenti për shkak të punës së ndjeshme për katër nivelet e klasifikimeve të sigurisë, por edhe deklasifikime për raste të caktuara, prej nivelit më të lartë, tepër sekret, sekret, konfidenciale. Gjithashtu, edhe procedura e ankimit pas verifikimit të sigurisë për zyrtarët apo për personelin e caktuar mbetet për t'u dëshiruar apo do të merren praktikat nga vendet e rajonit, për arsye se nëse në shkallën e dytë pas nivelit të brendshëm, ankesa shkon te gjykatësit, atëherë parashtrohet pyetje se a duhet ta kenë gjykatësit edhe verifikimin e sigurisë? Pra, edhe kjo është një çështje.

Një çështje që ndoshta është dashur të thuhet në mënyrë më të veçantë është se edhe deputetët në dy komisionet funksionale, në veçanti Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, por edhe Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe FSK a duhet të kenë verifikimin e sigurisë? Pra, edhe kjo çështje po shpresoj që me ligjin e ri do të rregullohet. Sido që të jetë, unë dua edhe një herë të theksoj një punë të mirë, një performansë të mirë të komisionit, ka bërë një propozim me këto çka edhe unë i dhashë si vërejtje që duhet të bëhen në të ardhmen, por shpresoj që me ligjin e ri kjo të rregullohet. Realisht kemi një defekt apo mundësi që shumë zyrtarë të institucioneve të sektorit të sigurisë, por edhe zyrtarë të tjerë të nivelit të autoriteteve, nivele ekzekutive, nuk kanë verifikimin e sigurisë mu për shkak që është bërë një formë, është shpërbërë ky departament dhe tash do të shkojë një kohë relativisht e gjatë derisa të bëhet ligji, derisa të përzgjidhen, të bëhet verifikimi i sigurisë së tyre dhe derisa ky institucion apo departament të bëhet funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë duhet të them që i lexova telegrafikisht dhe jam njëri nga ata që kam insistuar që të ndryshojë çështja e verifikimit, të hiqet prej AKI-së. Përveçse s'është organ ekzekutiv, ne nuk guxojmë të lejojmë që në shërbimin informativ të ketë agjenci të policisë politike, sepse atëherë shndërrohet në polici politike që me urdhër, e dihet që është në urdhrat e kryeministrit dhe të presidentit dhe në qoftë se AKI-ja vlerëson dhe verifikon figurat në përmasat që t'ua ndalojë apo të mos ua ndalojë angazhimin në një fushë të caktuar, atëherë për mua paraqet rrezik dhe mundësi të shkeljes së të drejtave të qytetarit dhe të njeriut në përgjithësi.

Por, unë mendoj që Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë me ligj i ka dy mbledhje në vit dhe nganjëherë më krijohet përshtypja se s'po di a është AKI-ja komision i parlamentit apo është AKI, nga deklaratat që i dëgjoj dhe konferencat për shtyp pas takimeve. Andaj unë mendoj që duhet të respektohen kompetencat dhe duhet të mbikëqyret AKI-ja në kuadër të kompetencave që ka, ndërsa fushat e tjera t'i sugjerojmë Qeverisë që të bëjë ligj më të mirë ose të amendamentojmë ligjin edhe ne si deputetë që e kemi atë kompetencë. Për rekomandimet, janë rekomandime, s'e obligojnë askënd, në fund të fundit, por mirë është që t'i votojmë. Faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur. Atëherë, ka numër të mjaftueshëm të deputetëve për t'i votuar rekomandimet, raportin me rekomandime. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Në sallë janë 67 deputetë. Kanë votuar 64 deputetë, për janë 61, kanë abstenuar 3.

Konstatoj që Kuvendi miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë lidhur me zbatimin e Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.

(Ndërhyrje)

A është zëvendësi i Naitit në komision këtu?

14. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë

Zëvendëskryetari nuk është këtu. A ka dikush që është i autorizuar? Nuk ka! Atëherë e lëmë për mbledhjen e radhës, meqenëse nuk ka raportues.

15. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar emërimin e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media nga dy kandidatët e propozuar. E ftoj kryetarin e Komisionit ad hoc, zotin Hajdar Beqa, që para deputetëve të Kuvendit t'i arsyetojë rekomandimet.

HAJDAR BEQA: Nënkyetar,

Komisioni e ka kryer punën e vet. Ne si grup e kemi shqyrtuar dhe e mbështesim tash si procedurë. I ftoj edhe deputetët e tjerë kolegë ta mbështesin.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj se Kuvendi duhet të zgjedhë një anëtar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë me votim të fshehtë nga kandidatët e propozuar, si në vijim:

1. Driton Qiriqi dhe
2. Vlorë Berisha.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues, në përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar, në mbështetje të zyrtarëve të Administratës së Kuvendit. Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar të komisionit votues.

Grupi Parlamentar i PDK-së, kë e propozon, zoti Pajaziti?

ZENUN PAJAZITI: Propozojmë deputetin Hajdar Beqa.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, kë propozon?

ISMET BEQIRI: Ne propozojmë deputetin Sadri Ferati.

KRYESUESI: Lëvizja “Vetëvendosje”, nuk doni në komision të merrni pjesë! Atëherë, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk dëshiron të marrë pjesë në komision.

Grupi Parlamentar i AAK-së. Lahi Brahimaj e ka fjalën.

LAHI BRAHIMAJ: Ne propozojmë Rustem Berishën.

KRYESUESI: Lista serbe, keni një kandidat. Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIČ: Hvala predsedavajući!

Poslanička grupa Srpska Lista predlaže poslanika Srđan Popović. Hvala!

KRYESUESI: Grupi “Nisma” nuk është. Grupi “6+”. Zoti Bajrami e ka fjalën.

ČERIM BAJRAMI: Propozojmë Kujtim Paqakun.

KRYESUESI: Atëherë, ju lus që deputetët t’i zënë vendet, komisioni, faktikisht dhe të përgatitemi për votim.

Besoj që ka kuorum të mjaftueshëm për të votuar. Ju lus që të qëndroni në sallë derisa të fillojë procesi i votimit, që ta konstatojmë kuorumin. Të mos votojmë dhe të na dalë pastaj më pak vota se njerëz. A ka dikush prapa në...

(Ndërprerje e incizimit)

Sa veta janë në sallë? A kemi kuorum, ju lus? E provojmë pra. Atëherë, po fillojmë me votimin menjëherë:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj- Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Çausi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Fatmir Shurdhaj, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kymete Bytyqi, Kujtim Paçaku, Labintë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkollli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka

Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nehat Baftiu, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Serxhan Popoviq, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, po fillojmë numërimin. Regjia, mikrofonin!

RRUSTEM BERISHA: Të nderuar të pranishëm,
Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie kanë votuar si vijon:

Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
E pavlefshme,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
E pavlefshme,
Vlora Berisha,
Vlora Berisha,
Vlora Berisha,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,

Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
E pavlefshme,
Vlora Berisha,
Vlora Berisha,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
E pavlefshme,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
E pavlefshme,
Driton Çeriqi,
E pavlefshme,
Vlora Berisha,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
E pavlefshme,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
Driton Çeriqi,
Vlora Berisha,
E pavlefshme dhe
Vlora Berisha.

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, fjalën zotit Beqaj.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit.

Për rezultatet e votimit për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie, Komisioni Votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Pavarur për Medie, në seancën plenare të mbajtur më 18 prill 2017, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 65 deputetë, të pavlefshme janë 8 fletëvotime, do të thotë 8 vota.

- Driton Çeriqi i ka fituar 32 vota dhe
- Vlora Berisha i ka fituar 25 vota.

Në bazë të ligjit nuk kalon asnjëri kandidat dhe përsëritet procedura e konkursit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Me kaq përfundon kjo seancë. Seanca e radhës është nesër, seancë e re, në orën 10:00. I lus kryetarët e grupeve parlamentare, deputetët, që të vijnë me kohë në seancë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*